

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8234
E martë, 3 shkurt 2026
Çmimi 0.50 €

Gjykata Kushtetuese
dhe ligjet diskriminuese
po kthejnë shqiptarët
para vitit 2001 ■ FAQE 10-13

INTERVISTË
SPECIALE E
SEKRETARIT TË
PËRGJITHSHËM
TË BDI-së,
ARBËR ADEMI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VENDIMET URGJENTE TË KUVENDIT PAS KONSTITUIMIT TË LEGJISLATURËS SË RE. ■ FAQE 3




Pas konstituimit të legjislaturës së re, Kuvendi i Kosovës duhet të adresojë një sërë vendimesh urgjente që janë vendimtare për funksionimin normal të rendit kushtetues dhe stabilitetin e institucioneve. Një nga prioritetet kryesore të Kuvendit është miratimi i Ligjit për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, ratifikimi i marrëveshjes me Bashkimin Evropian për Planin e Rritjes (880 milionë euro) dhe ratifikimi i marrëveshjes me Bankën Botërore (90 milionë euro). Instituti i Kosovës për Drejtësi vlerëson se legjislatura e re duhet të veprojë me urgjencë, përgjegjësi dhe transparencë, duke ç'bllokuar proceset kyçe që ka përpara

**KOSOVA
JASHTË
FARA-S
AMERIKANE
PËR GATI
DY VJET** ■ F. 4-5



**LISTA SERBE
APELON
VENDIMIN E
KQZ-së PËR
TË MOS IA
MIRATUAR LISTËN
E KANDIDATËVE** ■ F. 7



AKTUALE



**PROKURORIA AUTORIZON POLICINË
PËR HETIME LIDHUR ME NUMËRIMIN
E VOTAVE NË PODUJEVË** ■ F. 3

**LUMIR ABDIXHIKU I MBIJETON
VOTËBESIMIT NË KUVENDIN
E LDK-së** ■ F. 5

**ISUFAJ DHE DREJTUES TË
SISTEMIT PROKURORIAL NISIN
VIZITË ZYRTARE NË SHBA** ■ F. 6

EKONOMI



**RRITET INDEKSI I PËRGJITHSHËM
I ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE
BUJQËSORE** ■ F. 8

**RAFUNA: RRRITJA E ÇMIMIT TË
ENERGJISË DO TË GODASË BIZNESET
DHE QYTETARËT, PAS RRRITJES
16.1% TË VITIT TË KALUAR** ■ F. 8

SPORT



**PËRMBYLLET GRUMBULLIMI TREDITOR
I KOMBËTARES U17, STAFI TEKNIK I
KËNAQUR ME PUNËN E BËRË** ■ F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

UKRAINA PRET RAUNDIN E RI TË BISEDIMEVE TREPALËSHE, NDËRSA SHTOHEN SULMET VDEKJEPRURËSE RUSE

KIEV, 2 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se një raund i ri bisedimesh trepalëshe me Moskën dhe Uashingtonin është caktuar për datat 4 - 5 shkurt në Emiratet e Bashkuara Arabe, ndërsa takimi vjen pas një rundi tjetër sulmesh ajrore vdekjeprurëse ruse ndaj objekteve civile.

Në fjalimin e tij të përnatshëm me video më 1 shkurt, Zelensky tha se ekziston “një marrëveshje për të mbajtur një takim trepalësh në një nivel të përshtatshëm... të mërkurën dhe të enjten në Emiratet e Bashkuara Arabe, si herën e kaluar”.

Kishte pasiguri rreth bisedimeve, të cilat fillimisht ishin planifikuar të mbaheshin në kryeqytetin e Emirateve më 1 shkurt. Zelensky më 31 janar tha se ekipi i tij ishte gati për negociata të tilla, por se po priste përgjigje nga Shtetet e Bashkuara. “Kam planifikuar një takim për [2 shkurtin] me Rustem Umerovin”, tha Zelensky, duke iu referuar negociatorit kryesor të Kievit. Udhëheqësit ukrainas synojnë “të bien dakord për kornizën e bisedimeve [në Abu Dhabi] dhe të përgatisin gjithçka. Në mbrëmjen e [2 shkurtit], ekipi tashmë do të jetë rrugës për në negociata”.

“Shkurti do të jetë një periudhë e aktivitetit mjaft intensiv të politikës së jashtme nga ana jonë, me kontakte dhe takime që fillojnë që nesër”, shtoi Zelensky. “Ne presim që pala amerikane të jetë po aq aktive,

dhe veçanërisht kjo vlen për masat e de-përshkallëzimit, uljen e sulmeve. Dhe shumë varet nga ajo që pala amerikane do të arrijë, në mënyrë që njerëzit t’i besojnë si procesit ashtu edhe rezultateve, natyrisht”, shtoi ai. Zyrtarët amerikanë dhe rusë nuk komentuan menjëherë mbi deklaratat e Zelenskyt.

Bisedimet pasuese

Negociatat e drejtpërdrejta që përfshijnë Moskën dhe Kievin, së bashku me përfaqësues amerikanë, rifilluan në Abu Dhabi më 23 - 24 janar. Takimet mes negociatorëve ukrainas dhe rusë kanë qenë të rralla që nga pushtimi në shkallë të plotë i Kremlinit në shkurt të vitit 2022.

Më 30 janar, i dërguari i posaçëm amerikan, Steve Witkoff, u takua me negociatorin e Kremlinit, Kirill Dmitriev, në Miami për ato që ai i përshkroi si “takime produktive dhe konstruktive”. Witkoff tha se Sekretari i Thesarit, Scott Bessent, dhëndri i presidentit amerikan Donald Trump, Jared Kushner, si dhe këshilltari qeveritar Josh Gruenbaum, gjithashtu morën pjesë në bisedimet në Florida. Megjithatë, pavarësisht asaj që zyrtarët amerikanë e panë si një dinamikë pozitive në përpjekjet e ripërtërira diplomatike, sulmet ajrore ruse vazhduan të godasin infrastrukturën civile dhe logjistike në të gjithë Ukrainën, ndërsa temperaturat



në vend ranë deri në minus 30 gradë Celsius.

Zyrtarët ukrainas raportuan më 1 shkurt se dy sulme të ndara me dronë vranë të paktën 18 persona në rajonin juglindor të Ukrainës, Dnjepërpetrovsk, duke plagosur të paktën shtatë të tjerë.

Gjashtëmbëdhjetë persona u vranë kur një dron rus goditi pranë një autobusi në zonën e Pavlohradit, ndërsa dy të tjerë humbën jetën pasi një dron goditi një shtëpi private në kryeqytetin e rajonit, Dnjepër, më herët gjatë ditës.

DTEK, kompania më e madhe private e shërbimeve energjetike në Ukrainë, e cila ishte pronare e autobusit, shtoi se personat e vranë në zonën e Pavlohradit ishin minatorë që po ktheheshin nga turni i tyre i punës.

Detajet e sulmeve nuk mund të

verifikohen menjëherë në mënyrë të pavarur.

Goditet një spital materniteti

Veçmas, pati sulme ajrore të vazhdueshme në qytetin fqinj Zaporizhia, të cilat nisën pak pas mesnatës. Guvernatori rajonal, Ivan Fedorov, tha se të paktën gjashtë persona u plagosën në sulmin ndaj një spitali materniteti.

Fedorov shtoi se dy nga gratë e plagosura po i nënshtroheshin ekzaminimeve mjekësore në momentin e goditjes. Në një postim në Telegram që tregonte pasojat, ai e përshkroi sulmin si “edhe një dëshmi tjetër të një lufte të drejtuar kundër jetës”. Më vonë ai shtoi se një sulm i dytë ndaj qytetit, i cili ndodhet më pak se 50 kilometra nga vija

e frontit jugor të vendit, plagosi edhe tre persona të tjerë në një lagje tjetër. Guvernatori rajonal tha se mes të plagosurve ishte edhe një djalë i vogël.

Vazhdimi i sulmeve erdhi pasi Trump më 29 janar tha se presidenti rus, Vladimir Putin, i kishte premtuar personalisht atij se do të ndalte sulmet ajrore ndaj kryeqytetit dhe “qyteteve të ndryshme” të tjera për një javë. Katarina Mathernova, ambasadorja e BE-së në Ukrainë, kritikoi ashpër veprimet e fundit të Kremlinit në një postim në Facebook. “A është kështu si duhet të duket një ‘armëpushim?’” tha ajo. “Si shpërthime. Si civilë të vdekur. Si infrastrukturë energjetike dhe transporti e shkatërruar.” “Të gjitha këto po ndodhin në një kohë kur bota po flet për një armëpushim të mundshëm”, shtoi ajo.

TRUMPI: TEHERANI PO BISEDON SERIOZISHT ME UASHINGTONIN

UASHINGTON, 2 SHKURT - Presidenti amerikan, Donald Trump ka thënë se Irani është “duke biseduar seriozisht” me Shtetet e Bashkuara pas kërcënimeve të tij për veprime ushtarake dhe rritjes së prezencës së pajisjeve ushtarake amerikane në rajonin e Lindjes së Mesme.

Teherani “po bisedon me ne dhe do ta shohim nëse mund të bëjmë diçka. Përndryshe, do të shohim se çfarë ndodh. Kemi një flotë të madhe të nisur atje”, ka thënë Trump për Fox News më 31 janar. “Ata po negociojnë”.

Më vonë, Trump u ka thënë gazetarëve se ata “po angazhohen me ne në bisedime serioze”.

Ende nuk është bërë e qartë se nën çfarë rrethanash janë duke u zhvilluar ato bisedime.



Trump ka thënë se administrata amerikane i ka informuar aleatët në rajon për mundësinë e sulmeve ushtarake, duke cituar shqetësimet për sigurinë. “Nuk

mund t’ua tregojmë planin. Nëse ua tregoj planin, do të ishte pothuajse aq keq sa t’ua tregoja juve mediave planin. Në fakt, do të ishte edhe më keq”.

Presidenti amerikan po shtyn përpara një qasje të ashpër kundër regjimit autokratik të Iranit, në kohën e shtypjes së protestave antiqeveritare në rrugët e Teheranit dhe qyteteve tjera iraniane.

Më 29 janar, ai ka thënë se Irani duhet t’i japë fund programit bërthamor dhe të ndalë “vrasjen e protestuesve”, duke pretenduar se këto kërkesa u janë përcjellë zyrtarëve iranianë. Dy ditë më parë, Trump ka thënë se “armadë masive” është në drejtim të Iranit dhe që mund të veprojë “me shpejtësi” nëse është e nevojshme.

Shtetet e Bashkuara kanë nisur aeroplanmbajtëse dhe aeroplanë ushtarakë drejt brigjeve të Iranit në ditët e fundit.

Për shkak të bllokimit të

internetit në Iran është e vështirë që të vlerësohet numri i protestuesve të vranë gjatë protestave masive, të cilat duken se janë zvogëluar në ditët e fundit.

Organizata për të drejta të njeriut HRANA, me seli në Shtetet e Bashkuara, ka konfirmuar se numri i të vranëve shkon në mbi 6.000 ndërsa i të arrestuarve në mbi 49.000.

Disa media citojnë burime tjera që e çojnë numrin e të vranëve në dhjetëra mijëra.

Irani është përfshirë nga trazira prej 28 dhjetorit 2025, pas nisjes së protestave paqësore në rrugët e Teheranit, përmes së cilave u kërkohej autoriteteve që të ndalnin inflacionin dhe të forconin valutën shtetërore, të zhvlerësuar së fundmi në nivele rekorde.

VENDIMET URGJENTE TË KUVENDIT PAS KONSTITUIMIT TË LEGJISLATURËS SË RE

Pas konstituimit të legjislaturës së re, Kuvendi i Kosovës duhet të adresojë një sërë vendimesh urgjente që janë vendimtare për funksionimin normal të rendit kushtetues dhe stabilitetin e institucioneve. Një nga prioritetet kryesore të Kuvendit është miratimi i Ligjit për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, ratifikimi i marrëveshjes me Bashkimin Evropian për Planin e Rritjes (880 milionë euro) dhe ratifikimi i marrëveshjes me Bankën Botërore (90 milionë euro). Instituti i Kosovës për Drejtësi vlerëson se legjislatura e re duhet të veprojë me urgjencë, përgjegjësi dhe transparencë, duke ç'bllokuar proceset kyçe që ka përpara

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 SHKURT - Instituti i Kosovës për Drejtësi ka vlerësuar se pas konstituimit të legjislaturës së re, Kuvendi i Kosovës duhet të adresojë një sërë vendimesh urgjente që janë vendimtare për funksionimin normal të rendit kushtetues dhe stabilitetin e institucioneve. Sipas IKD-së, këto vendime nuk janë vetëm obligime politike, por detyrime të drejtpërdrejta kushtetuese dhe ligjore, të cilat kërkojnë veprim të menjëhershëm dhe të përgjegjshëm nga përfaqësuesit e zgjedhur të qytetarëve. “Një nga prioritetet kryesore të Kuvendit është miratimi i Ligjit për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, ratifikimi i marrëveshjes me

Bashkimin Evropian për Planin e Rritjes (880 milionë euro) dhe ratifikimi i marrëveshjes me Bankën Botërore (90 milionë euro). Këto vendime janë të domosdoshme për avancimin e interesave strategjike nacionale, zbatimin e obligimeve ndërkombëtare, funksionimin financiar të shtetit, zbatimin e politikave publike dhe shmangien e pasigurisë së institucioneve”, ka vlerësuar IKD-së.

Po ashtu, sipas IKD-së, Kuvendi duhet të sigurojë financimin e Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) dhe mbështetjen financiare për komunat, si pjesë e obligimeve ligjore dhe politike për garantimin e shërbimeve publike dhe funksionimit të komunave në gjithë territorin e vendit. “Një prioritet po aq i rëndësishëm mbetet zbatimi i aktgjyqimeve të Gjykatës



Kushtetuese, përfshirë aktgjykimin për Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe të drejtat e mbi 94 mijë zyrtarëve publikë. Moszbatimi i këtyre vendimeve cenon drejtpërdrejt parimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve në rendin kushtetues”, thuhet në komunikatën e IKD-së. Instituti i Kosovës për Drejtësi vlerëson se legjislatura e re duhet të veprojë me urgjencë, përgjegjësi dhe transparencë, duke ç'bllokuar proceset kyçe, zbatuar aktgjykimet kushtetuese dhe forcuar rolin mbikëqyrës të Kuvendit, në funksion të garantimit të rendit demokratik dhe interesit publik. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka shpallur të shtunën rezultatet përfundimtare të

zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit në Kosovë. Sipas të dhënave të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje i ka fituar 51.10 për qind të votave, apo 57 ulëse në Kuvendin e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, 20.19 për qind të votave apo 22 ulëse, Lidhja Demokratike e Kosovës, 13.24 për qind të votave apo 15 ulëse, dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 5.50 për qind të votave apo gjashtë ulëse. Nga ulëset e rezervuara për minoritetin serb, nëntë ulëse i ka fituar Lista Serbe dhe një ulëse, Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. KQZ-ja i ka publikuar këto rezultate pasi e ka përfunduar të premtën në mbrëmje procesin e

rinumërimit të votave. Rinumërimi është kryer pas dyshimeve për manipulime me votat e kandidatëve për deputetë. Përgjatë procesit, votat për disa kandidatë ndryshuan - me raste deri në 6 mijë për një individ - ndërsa ato për partitë nuk u cenuan. Autoritetet e zbatimit të ligjit kanë intervistuar qindra njerëz, kanë ndaluar dhjetëra dhe po i vazhdojnë hetimet. Për disa zyrtarë shtetërorë, ky ka qenë “procesi më i komprometuar zgjedhor” në Kosovë, pasi vendi është lavdëruar shpesh nga organizata vendore dhe ndërkombëtare për organizim të proceseve zgjedhore të drejta dhe transparente.

PROKURORIA AUTORIZON POLICINË PËR HETIME LIDHUR ME NUMËRIMIN E VOTAVE NË PODUJEVË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 SHKURT - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka autorizuar Policinë e Kosovës për grumbullimin dhe mbledhjen e provave lidhur me dyshimet për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në komunën e Podujevës. Sipas njoftimit të Prokurorisë, autorizimi është dhënë për Drejtorinë e Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, në kuadër të dyshimeve për kryerjen e veprave penale që lidhen me cenimin e të drejtave të votimit. Prokuroria ka bërë të ditur se gjatë këtij procesi ekzistojnë dyshime për parregullsi, përkatësisht mospërputhje në numrin e votave të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pas përfundimit të numërimit të votave në Podujevë. Autoritetet nuk kanë dhënë detaje shtesë lidhur me natyrën e mospërputhjeve apo numrin e



personave që mund të jenë përfshirë në këtë fazë të hetimeve. Hetimet lidhen me procesin zgjedhor për Kuvendin e Kosovës dhe vijnë në një kohë kur autoritetet kanë paralajmëruar rritje të vëmendjes ndaj çdo dyshimi për manipulim të votave apo shkelje të integritetit të procesit zgjedhor. Ditëve të fundit, autoritetet në Kosovë kanë intervistuar qindra njerëz nëpër komuna të ndryshme, dhe kanë ndaluar

dhjetëra, nën dyshimet e njëjta. Përgjatë procesit të rinumërimit, votat për disa kandidatë ndryshuan - me raste deri në 6 mijë për një individ - ndërsa ato për partitë nuk u cenuan. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, çdo manipulim i qëllimshëm i votës apo rezultatit zgjedhor përbën vepër penale dhe dënohet me deri në pesë vjet burgim. Për disa zyrtarë shtetërorë, ky ka qenë “procesi më i komprometuar zgjedhor” në

Kosovë, pasi vendi është lavdëruar shpesh nga organizata vendore dhe ndërkombëtare për organizim të proceseve zgjedhore të drejta dhe transparente. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e ka përfunduar procesin e rinumërimit të premtën në mbrëmje, ndërsa i ka publikuar rezultatet përfundimtare të shtunën. Anëtarët e KQZ-së i kanë miratuar listat e kandidatëve të të gjitha partive, përveç asaj të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë. Lista Serbe dhe Beogradi zyrtar kanë reaguar ashpër ndaj këtij vendimi, ndërsa partia serbe ka thënë se do të ushtrojë ankesë. Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se palët mund ta shfrytëzojnë të drejtën e ankesës për 48 orë pas shpalljes së rezultateve. Sipas të dhënave të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje i ka fituar 51.10 për qind të votave, apo 57 ulëse në Kuvendin e Kosovës,

Partia Demokratike e Kosovës, 20.19 për qind të votave apo 22 ulëse, Lidhja Demokratike e Kosovës, 13.24 për qind të votave apo 15 ulëse, dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 5.50 për qind të votave apo gjashtë ulëse. Nga ulëset e rezervuara për minoritetin serb, nëntë ulëse i ka fituar Lista Serbe dhe një ulëse, Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. Pas certifikimit të rezultateve, hapet rruga për formim të institucioneve të reja. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti me partinë e tij, Lëvizjen Vetëvendosje pritet ta formojë pa probleme Qeverinë e re. Megjithatë, ai e ka pranuar vetë një ditë më parë se do të duhet të krijohet një raport i ri mes pushtetit dhe opozitës për çështje tjera madhore, siç është ajo e pozitës së presidentit apo miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. Për të dyja proceset duhet siguruar dy të tretat e votave.



KOSOVA JASHTË FARA-S AMERIKANE PËR GATI DY VJET

Që nga qershori i vitit 2024, Kosova nuk ka asnjë kontratë lobimi të regjistruar në ueb-faqen e Aktit të Regjistrimit të Agjentëve të Huaj (FARA) të Departamentit amerikan të Drejtësisë. Derisa institucionet heshtin, ekspertët paralajmërojnë se pa një strukturë të tillë lobimi, Kosova mund të keqkuptojë prioritetet e SHBA-së dhe të lejojë që të tjerët ta formësojnë narrativin për të. Serbia ka gjashtë kontrata aktive në FARA, ndërsa vendet e tjera të rajonit kanë aktivitet të ndryshëm

PRISHTINË, 2 SHKURT - Në mungesë të lobimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u shfaq muajt e fundit si një ndër figurat më aktive në arenën ndërkombëtare. Pjesëmarrja e saj në ceremoninë e nënshkrimit të Kartës së Bordit të Paqes për Gazën dhe takimet me presidentin amerikan, Donald Trump - me shtrëngime duarsh dhe biseda vesh më vesh - kapën vëmendjen e mediave ndërkombëtare. Vendi me rreth 1.5 milion banorë tregoi se diplomacia aktive mund ta mbajë atë të dukshëm. “Është një nismë historike, me një vizion të qartë: për të sjellë më shumë paqe dhe siguri në botë”, tha Osmani pasi nënshkroi Kartën e Bordit të Paqes më 22 janar. Kjo nismë nuk u prit pa dilema. Demokraci si Franca dhe Gjermania e refuzuan pjesëmarrjen në të, duke paralajmëruar se ajo mund të dobësojë rolin e OKB-së dhe të hapë derën për figura si presidenti rus, Vladimir Putin. Edhe në Kosovë, reagimet ishin të ndara: për disa, pjesëmarrja

është një hap drejt rritjes së peshës ndërkombëtare të vendit, për të tjerë - një rreshtim i rrezikshëm përkrah regjimeve autoritare, përfshirë Bjellorusinë. Kështu, debati rreth Bordit të Paqes la në hije një çështje tjetër thelbësore: mungesën e lobimit shtetëror të Kosovës në SHBA. Donika Emini, njohëse e zhvillimeve politike, thotë se Kosova, për gati dy vjet, ka pasur shumë pak zëra aktivë në Uashington - jo për mungesë temash, por për mungesë strukture. Vendi nuk ka asnjë kontratë aktive lobimi në regjistrin e Agjentëve të Huaj të Departamentit të Drejtësisë amerikane, të njohur si FARA, që nga qershori i vitit 2024. Kjo, pavarësisht se lobimi i tillë i lejon çdo shteti të huaj të tentojë të ndikojë ligjërisht në politikat e SHBA-së. Sipas Eminit, mungesa e këtij mekanizmi e dobëson aftësinë e Kosovës për të komunikuar interesat e saj, sepse, siç thotë, angazhimi individual i një zyrtari nuk mund ta zëvendësojë një strukturë profesionale lobimi - veçanërisht në SHBA. “Është

realisht shqetësuese, për faktin se SHBA-ja nuk funksionon si Bashkimi Evropian. Me vendet e BE-së, me vetë Brukselin, mund t'i menaxhosh marrëdhëniet bilaterale vetë, përmes kanaleve zyrtare, përfaqësuesve të shtetit. Në SHBA funksionon ajo platformë [FARA] dhe ajo mundësi, sepse gjithçka bëhet përmes lobimit. Asgjë nuk është rastësore”, thotë Emini, nga Grupi Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë, për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Që nga fillimi i viteve '90, Kosova ka paguar kompani të shumta lobimi në SHBA, me qindra mijëra dollarë, për të promovuar agjendën e saj ndërkombëtare. Kontratat janë lidhur nga institucionet shtetërore me emra të njohur amerikanë, si Podesta Group dhe Ballard Partners. Në pesë vjetët e fundit, gjatë pushtetit të presidentes Osmani dhe Qeverisë së Albin Kurtit, janë nënshkruar vetëm tri kontrata lobimi - të gjitha në vitin 2023: njëra afatshkurtër dhe dy të tjera që skaduan një vit më vonë. Radio Evropa e Lirë ka kërkuar sqarime nga Presidenca, Qeveria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me arsyet përse Kosova, aktualisht, nuk ka asnjë kontratë aktive lobimi të regjistruar në FARA. Deri më tani, asnjëri prej institucioneve nuk ka kthyer përgjigje, duke i lënë të hapura pyetjet për mungesën e një strategjie të qartë, planifikimin dhe koordinimin institucional. Në një prej deklarimeve të rralla për çështjen e lobimit, ministria e Jashtme, Donika Gërvalla - tani në detyrë - ka thënë se “po

konsiderohet” vazhdimi i kontratave me dy kompanitë e kontraktuara më 2023 - të Avni Mustafajt dhe Afërdita Rakipit. Por, edhe gati një vit e gjysmë më vonë, kjo nuk ka ndodhur. Gërvalla ka deklaruar se është e kënaqur me punën e tyre, edhe pse shumica e shpenzimeve u kanë shkruar për dreka, udhëtime dhe takime në Prishtinë. “Nuk ka shqetësime lidhur me këto kontrata. Ata dy punojnë së bashku në realizimin e detyrave të tyre”, ka thënë atëkohë Gërvalla.

Sipas Eminit, Kosova e merr për të mirëqenë mbështetjen politike të SHBA-së, pa kuptuar ndryshimet drastike të elitave politike, që kanë ndodhur atje. “Nuk jemi në vitet '90. Nuk kemi një elitë politike në SHBA që e njeh Ballkanin në detaje. Nuk kemi lobistë, senatorë apo kongresistë siç i kemi pasur dikur, të cilët e kanë pasur kauzë politike avancimin e Ballkanit”, thotë Emini.

Vesko Garçeviq, profesor i Praktikës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Bostonit, thotë se pa lobistë që japin informacion nga brenda, Kosova rrezikon t'i keqkuptojë prioritetet e SHBA-së, duke hartuar politika që nuk përshtaten me pritjet e Uashingtonit dhe, për pasojë, marrin pak mbështetje. Në këtë mënyrë, Kosova - kushtimisht thënë - rrezikon edhe “të harrohet”, duke u dhënë hapësirë të tjerëve që ta krijojnë narrativin për të. “Serbia, sidomos, ka investuar jashtëzakonisht shumë, si financiarisht, ashtu edhe përmes lidhjeve të saj, në ndërtimin e

rrjetit të lobimit. Ndaj, po të isha në vendin e Qeverisë së Kosovës, do ta bëja të njëjtën gjë. Do të mendoja për të angazhuar dikë me ndikim që i përfaqëson interesat e Kosovës - jashtë zyrës diplomatike që Kosova ka në Uashington”, thotë Garçeviq për Exposenë.

Serbia, aktualisht, ka gjashtë kontrata aktive në Aktin e Regjistrimit të Agjentëve të Huaj - FARA. Njëra prej tyre përfshin edhe avokim para Kongresit amerikan dhe departamenteve të tij.

Nga vendet e tjera të rajonit, Bosnje e Hercegovina ka 14 kontrata aktive, shumica prej tyre të lidhura nga Republika Serpska; Shqipëria ka katër, ndërsa Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut nuk kanë asnjë. Garçeviq, ish-ambasador i Malit të Zi në disa vende evropiane, thotë se lobimi e kompenson peshën e kufizuar diplomatike të një vendi. Ndryshe nga vendet e mëdha, shtetet e vogla - si Kosova dhe Mali i Zi - nuk kanë ndikim të madh ekonomik, ushtarak apo strategjik, prandaj nuk e tërheqin automatikisht vëmendjen e Uashingtonit. Ai shpjegon se lobimi i vazhdueshëm ka bërë që SHBA-ja ta perceptonte pozitivisht kandidaturën e Malit të Zi për NATO, dhe ka luajtur rol vendimtar në arritjen e suksesit. “Shumë kohë përpara se të merrej vendimi më 2017, ne kemi gjetur një grup lobimi shumë efektiv, që ka punuar në favor të Malit të Zi. Kur ne kemi nisur fushatën për anëtarësim, NATO-ja nuk ka qenë e etur për të pranuar anëtar të ri. Kjo ka ndryshuar me kalimin e kohës,

LUMIR ABDIXHIKU I MBIJETON VOTËBESIMIT NË KUVENDIN E LDK-së

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) Lumir Abdixhiku i ka mbijetuar votëbesimit që e ka kërkuar të shtunën në Kuvendin e partisë.

Abdixhiku ka thënë se Kuvendi ka zhvilluar mbi shtatë orë diskutime, ndërsa vazhdimin e qëndrimit në krye të partisë e ka përshkruar si privilegj dhe përgjegjësi. “Me votim të mbyllur u dha verdikti i anëtarësisë së LDK-së për të cilin jam falënderues, por po ashtu jam edhe mirënjohës i mbështetjes së vazhdueshme, por edhe kundërshtimeve në këtë proces përpara”, u ka thënë ai mediave pas përfundimit të procesit të votimit.

Abdixhiku ka thënë se partia i ka miratuar dy deklarata politike: një për riorganizim të partisë, dhe tjetër për gjendjen politike në Kosovë.

Sa i përket deklaratës së dytë, ai ka thënë se partia është zotuar për diskutime të hapura me gjithë spektrin politik, me qëllim të ofrimit të një stabiliteti për të ardhmen e Republikës së

Kosovës. Ai ka thënë se partia është e interesuar të gjejë konsensus edhe për çështjen e presidentit të Kosovës.

Abdixhiku ia ka ofruar Kuvendit të partisë dorëheqjen e tij nga pozita e kryetarit, pas rezultatit të shënuar në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit.

Në këtë proces zgjedhor, LDK-ja fitoi 13.24 për qind të votave - rezultati i dytë më i keq qysh prej pasluftës.

Por, disa figura partiake kanë kërkuar dorëheqjen e tij të paravokueshme, duke mos u pajtuar me votëbesim.

Në mesin e tyre është Hykmete Bajrami, e cila ka dhënë dorëheqje të paravokueshme nga pozita e nënkryetares së partisë dhe e ka kërkuar të njëjtën edhe nga Abdixhiku.

Ajo ka thënë pas përfundimit të punimeve të Kuvendit, se e respekton vendimin e marrë të shtunën. “LDK është më e madhe sesa secili prej nesh”.

Anëtari tjetër i kësaj partie, Avdullah Hoti e ka shpallur ditë më parë kandidaturën për



kryetar të partisë, por të shtunën duket se ka pasur diskutime vetëm për performancën e Abdixhikut.

Lidhja Demokratike e Kosovës është një nga partitë më të vjetra në Kosovë, e themeluar në vitin 1989 nga Ibrahim Rugova.

Ajo ka luajtur rol kyç në periudhën e rezistencës paqësore dhe në ndërtimin e institucioneve demokratike të vendit.

TË AKUZUARIT PËR MASAKRËN NË IZBICË I ULET DËNIMI GJATË RIGJYKIMIT, DËNOHET VEÇ 13 VJET BURGIM



PRISHTINË, 2 SHKURT - Gjatë rigjykimit, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 13 vjet burgim Muhamet Alidemajn, i akuzuar për krime lufte, përkatësisht për pjesëmarrje në kryerjen e masakrës së Izbicës, raporton Betimi për Drejtësi.

Në gjykimin e parë, Alidemaj, që sipas aktakuzës ishte pjesëtar i forcave policore dhe ushtarake serbe gjatë periudhës së luftës, ishte dënuar me 15 vjet burgim.

Në Izbicë të Skenderajt, forcat serbe vranë 130 persona në mars të vitit 1999.

Alidemaj ishte arrestuar në

mars të vitit 2021 dhe ishte dënuar në korrik të vitit 2024. Por, një vit më vonë Gjykata e Apelit e ktheu në rigjykim rastin.

Si në gjykimin e parë, ashtu edhe në rigjykim, Alidemaj - shtetas i Serbisë me nacionalitet shqiptar - ishte deklaruar i pafajshëm për krime lufte.

Sipas aktakuzës të publikuar në fund të marsit të vitit 2022, thuhet se Alidemaj, së bashku me forcat ushtarake dhe policore serbe, i ndanë gratë dhe fëmijët nën moshën 12-vjeçare nga turma dhe nën kërcënimin e armëve i

detyruan të shkojnë në drejtim të Shqipërisë.

Burrat që mbeten në fshat, sipas aktakuzës, u ekzekutuan me armë automatike dhe nga viktimat janë identifikuar 114 prej tyre, ndërkaq 12 i kanë mbijetuar ekzekutimit.

Prokuroria ka thënë se pas dy muajve, trupat e viktimave u zhvarrosën dhe u transportuan me disa kamionë në drejtim të panjohur. Pas përfundimit të luftës, trupat e viktimave në Izbicë u gjetën në varreza masive në Batajnicë të Serbisë, në fshatin Suhodoll të Mitrovicës dhe në Novolan të Vushtrrisë.

dhe mund të them se lobistët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces”, thotë Garçeviq.

Në rrethanat ku gjendet Kosova - me çështje të hapura me Serbinë dhe jashtë NATO-s e BE-së - lobimi në SHBA nuk është vetëm çështje imazhi. Ai është mjet kyç edhe për mbrojtjen e sigurisë civile dhe për të siguruar që SHBA-ja mbetet e angazhuar në stabilitetin dhe mbrojtjen e vendit, sipas Garçeviqit. “Prandaj, mos ua lini të tjerëve që ta formësojnë mënyrën se si SHBA-ja ju qaset. Duhet të jeni proaktivë, sepse kjo ju ndihmon edhe të kuptoni më mirë se si

mendohet nga brenda. Njerëzit që i angazhoni për të punuar për ju, mund t’ju japin vlerësime reale se çfarë ndodh në anën tjetër dhe si e shohin ata situatën”, thotë ai.

Emini shton se realiteti politik në Uashington ka ndryshuar ndjeshëm dhe se vendimmarrja sot zhvillohet në një mjedis shumë më të fragmentuar. Sipas saj, Qeveria e re e Kosovës, që pritet të formohet sërisht nga Albin Kurti, duhet të investojë në ndërtimin e rrjeteve afatgjate të lobimit në SHBA, e jo të mbështetet në komunikim sporadik apo vetëm në vizita zyrtare.

“Kosova është një shtet i vogël dhe si i tillë mbijeton në aleanca. Edhe sikur të ishte shtetësi e përfunduar, edhe nëse do të kishte ushtri dhe do të ishte pjesë e NATO-s, aleancat janë të domosdoshme”, thotë Emini. Marrëdhëniet mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara kanë kaluar periudha tensioni gjatë dy vjetëve të fundit. Shkak janë bërë disa vendime të Qeverisë së Kosovës, të cilat Uashingtoni i ka vlerësuar si të dëmshme për komunitetin serb. Përplasjet kanë kulmuar me paralajmërime publike nga zyrtarët amerikanë për përqendrim të raporteve dhe me vendosjen e masave

ndëshkuese ndaj Kosovës, ndonëse Qeveria e Kurtit ka insistuar se këto mospajtime janë pjesë e një dinamike normale mes aleatëve.

Këtë muaj, Kosova u përfshi edhe në listën e 75 vendeve për qytetarët e të cilave SHBA-ja ka pezulluar përkohësisht lëshimin e vizave të emigrimit. Arsyeja zyrtare: parandalimi i keqpërdorimit të ndihmave sociale. Në këtë listë janë përfshirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përveç Serbisë, e cila, sipas raportimeve të disa mediave, ka përfutur edhe nga lobimi intensiv. Megjithatë, Departamenti

amerikan i Shtetit ka sqaruar se masa synon ata që “i përdorin ndihmat sociale amerikane në nivele të papranueshme”.

Në një Uashington ku vëmendja blihet, fitohet ose humbet, sfida për Kosovën tani nuk qëndron vetëm te ruajtja e miqësive, por edhe tek aftësia për t’u dëgjuar. Me fjalët e presidentes Osmani, pas nënshkrimit të Kartës së Bordit të Paqes, “kur Amerika udhëheq, pagja është gjithmonë më e sigurt”. Por, mbetet të shihet nëse Kosova do të arrijë ta shndërrojë këtë moment në ndikim real - përtej dorështrëngimeve dhe titujve në media.

Isufaj dhe drejtues të sistemit prokurorial nisin vizitë zyrtare në ShBA

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Sami Istrefi dhe prokurori special, Naim Abazi, me ftesë të institucioneve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nisin vizitën zyrtare në Washington, ku do të marrin pjesë në aktivitete zyrtare dhe do të zhvillojnë

takime të rëndësishme. Gjatë qëndrimit të tyre në ShBA, do të marrin pjesë në ceremonitë e organizuara me rastin e Lutjeve të Mëngjesit (National Prayer Breakfast), një ngjarje tradicionale me karakter institucional dhe ndërkombëtar, e cila mbledh përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore nga vende të ndryshme. Në kuadër të kësaj vizite zyrtare, përfaqësuesit e

sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës do të zhvillojnë takime me zyrtarë të lartë amerikanë, ku pritet të diskutohen mundësitë për avancimin e bashkëpunimit profesional dhe krijimin e partneriteteve ndërshtetërore, në funksion të rritjes së efikasitetit në ushtrimin e detyrave dhe kompetencave përkatëse, si dhe forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



ATK-ja PARALAJMËRON BIZNESET E PAREGJISTRUARA: REGJISTROHUNI OSE PËRBALLUNI ME GJOBA DHE SANKSIONE

PRISHTINË, 2 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës ka rikujtuar edhe një herë për të gjithë personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik, se regjistrimi i aktivitetit është obligim ligjor dhe shmang pasoja serioze financiare dhe ligjore. Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se në kuadër të projektit për formalizimin e ekonomisë dhe vendosjen e

etiketave identifikuese për bizneset e regjistruara, ATK-ja do të shtojë inspektimet në terren në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. “ATK u bën thirrje të gjithë personave që ende zhvillojnë aktivitet të paregjistruar që të veprojnë menjëherë dhe të regjistrohen vullnetarisht në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), përpara se të identifikohen nga inspektorët



tatimorë”, thuhet në njoftim. Nga ATK-ja po ashtu thonë se në rast se gjatë inspektimeve identifikohen aktivitete të paregjistruara, ATK, në

përputhje me Ligjin në fuqi, do të ndërmarrë pa përjashtim këto veprime: “Regjistrimin e detyrueshëm të aktivitetit dhe pajisjen me Numër Fiskal; Aplikimin e gjobave dhe sanksioneve ligjore të parapara”. Tutje bëhet me dije se regjistrimi vullnetar shmang penaltitetet dhe kontribuon në një konkurrencë të drejtë në treg. “Po ashtu, ATK kërkon nga

të gjithë tatimpaguesit e regjistruar që të verifikojnë dhe përditësojnë të dhënat e tyre në sistemin tatimor, pasi mos-përditësimi i informatave përbën shkelje ligjore. Administrata Tatimore e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftimin e ekonomisë joformale dhe në ndërtimin e një sistemi tatimor të drejtë, transparent dhe të barabartë për të gjithë”, thuhet në njoftim.

LV-ja MBAN MBLEDHJEN E PARË ME QENDRAT PAS ZGJEDHJEVE, THEKSOHET ORGANIZIMI DHE KONSTITUIMI I INSTITUCIONEVE TË REJA



PRISHTINË, 2 SHKURT - Në zyrën qendrore të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë është mbajtur mbledhja e përbashkët me drejtuesit e qendrave të kësaj lëvizje. Kjo ishte mbledhja e parë me qendrat pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe përmbylljes së cikleve zgjedhore lokale, si vazhdim i organizimit dhe

angazhimit tonë në terren. Në mbledhje ishin të pranishëm kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje!, Albin Kurti, sekretari organizativ, Alim Rama, si dhe koordinatori i Qendrave, Salih Zyba. “Gjatë takimit u diskutua gjerësisht për situatën aktuale politike në vend dhe për fushatën tonë zgjedhore të suksesshme, e cila u kurorëzua me mbështetje

qytetare prej 51.10% dhe 57 ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, u trajtuan çështje që lidhen me procesin e certifikimit të rezultatit zgjedhor dhe konstituimin e institucioneve të reja. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe aspektit organizativ të Lëvizjes, funksionimit dhe organizimit nëpër qendra, si dhe

çështjeve të tjera të rëndësishme për forcimin e mëtejme të strukturave tona. Lëvizja Vetëvendosje! mbetet e përkushtuar ndaj organizimit të brendshëm demokratik, përfaqësimit të denjë të qytetarëve dhe realizimit të programit tonë qeverisës në shërbim të Republikës”, ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.

FILLOI ZBATIMI I PROJEKTIT ‘EDUKIMI MEDIATIK - EKSPERTIZA NORDIKE NË KOSOVË’ NË SHKOLLËN ‘SHABAN SHALA’ NË PODUJEVË

PODUJEVË, 2 SHKURT - Në Shkollën “Shaban Shala” në Podujevë ka filluar zbatimi i projektit “Edukimi Mediatik - Ekspertiza Nordike në Kosovë” që buron nga një memorandum bashkëpunimi i nënshkruar në nëntor ndërmjet Komunës dhe Iniciativës EEI (Education Empowerment Initiative). Në këtë ceremoni që është mbajtur në ambientet e kësaj Shkolle (si përfituese e këtij

projekti) mori pjesë kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Eevamari Laaksonen, Konsulli i Norvegjisë në Kosovë, Taulant Hodaj, përfaqësuese të Iniciativës EEI, drejtori i DKA-së, Avni Fetahu, drejtori i shkollës, Nystret Ismajli, mësimdhënës dhe nxënës. Me këtë rast, kryetari Bulliqi theksoi se edukimi medial është domosdoshmëri në kohën e



sotme dhe një investim i drejtpërdrejtë në të ardhmen e

fëmijëve, duke i pajisur ata me njohuri për të kuptuar dhe vlerësuar drejt informacionin. Ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Eevamari Laaksonen, falënderoi Komunën e Podujevës për bashkëpunimin, duke theksuar rëndësinë e barazisë në arsim, mendimit kritik dhe përgatitjes së nxënësve për të qenë qytetarë aktivë në demokraci, si dhe ndarjen e përvojës finlandeze në edukimin medial.

Gjatë kësaj ceremonie u zhvillua një bashkëbisedim me nxënësit rreth mënyrës se si ata i përdorin mediat dhe informacionet digjitale, me theks të veçantë në verifikimin e burimeve dhe përdorimin e përgjegjshëm të tyre. Projekti ka për synim forcimin e edukimit medial, mendimit kritik dhe përdorimit të sigurt të mediave digjitale në shkolla, përmes përvojës dhe praktikave nordike.

Komuna e Mitrovicës zhvendos kiosqet për qarkullim më të mirë dhe barazi për shitësit

MITROVICË, 2 SHKURT - Drejtoria e Inspektionit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm, kanë zhvilluar një aksion për ripozicionimin e kiosqeve në zonën e sheshit të qytetit, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e veprimtarisë së tyre dhe trajtimit të barabartë të të

gjithë operatorëve. Qëllimi i këtij aksioni nuk ka qenë largimi i kiosqeve nga hapësirat publike, por vendosja e tyre në lokacione më të përshtatshme, të përcaktuara dhe funksionale, ku ato mund të operojnë në mënyrë më të rregullt dhe më të favorshme. Me këtë rast, kiosqet janë

ripozicionuar në sheshin “Adem Jashari”, konkretisht në hyrje të sheshit të qytetit, një lokacion i cili vlerësohet si i përshtatshëm dhe i favorshëm për zhvillimin e veprimtarisë së tyre tregtare. Aksioni është përcjellë nga drejtori i Inspektionit, Mujë Igrishta, dhe drejtori për Planifikim dhe Urbanizëm,

Ardian Kavaja. Komuna e Mitrovicës mbetet e përkushtuar për rregull urban, trajtim të barabartë për të gjithë dhe përdorim të drejtë të hapësirave publike, duke synuar një ambient më funksional dhe më të organizuar për qytetarët dhe bizneset.



Haradinaj, vizitë zyrtare në Uashington

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka mbërritur të hënën në Uashington, duke nisur vizitën e tij zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai është i ftuar në Lutjet e

Mëngjesit “National Prayer Breakfast” dhe do të marrë pjesë në aktivitete zyrtare, si dhe do të zhvillojë takime me liderë politikë nga mbarë bota. Gjatë qëndrimit të tij, Haradinaj do të zhvillojë takime në Kongresin Amerikan dhe institucione të tjera në Uashington, do të

mbajë një fjalim në Capitol Hill dhe do të diskutojë për partneritetin strategjik, forcimin e marrëdhënieve bilaterale të Kosovës me SHBA-të, sigurinë rajonale dhe bashkëpunimin transatlantik, me theks në anëtarësimin e Kosovës në NATO.



LISTA SERBE APELON VENDIMIN E KQZ-së PËR TË MOS IA MIRATUAR LISTËN E KANDIDATËVE

Prishtinë, 2 shkurt - Dy ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Lista Serbe ka dorëzuar një ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) kundër vendimit të këtij institucioni për mosmiratimin e listës së kandidatëve të saj. Në një deklaratë për media, Igor Simiq, përfaqësues i Listës Serbe, e ka cilësuar vendimin si “të paligjshëm, anti-serb dhe diskriminues” dhe ka thënë se KQZ-ja ka mohuar “42.759 vota të serbëve”, duke u munduar të pengojë komunitetin serb të zgjedhë përfaqësuesit e tij. “Presim që PZAP-ja ta shfuqizojë vendimin e turpshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të marrë një vendim në përputhje me ligjin, me ç’rast do të mbrojë të drejtat e popullit serb, ligjshmërinë dhe integritetin e procesit zgjedhor”, tha Simiq. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka thënë se është duke ndjekur



këto zhvillime dhe ka theksuar nevojën për “përputhje të plotë dhe respektim të standardeve ndërkombëtare zgjedhore, veçanërisht publikimin transparent dhe të plotë të rezultateve zgjedhore”. Gjatë fundjavës, ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Marko Gjuriq, e ka dënuar

gjithashtu vendimin e KQZ-së, duke e cilësuar si një sulm të ri ndaj të drejtave politike të popullit serb në Kosovë. Ai tha se heqja e të drejtës së votës së serbëve nuk duhet të jetë praktikë dhe se Serbia do të insistojë bashkë me partnerët ndërkombëtarë për respektimin e të drejtave politike dhe

elektorale të komunitetit serb. KQZ-ja kishte përfunduar të premten procesin e rinumërimit të votave, i cili u krye pas dyshimeve për manipulime gjatë numërimit të votave të kandidatëve për deputetë. Pas rinumërimit, disa vota ndryshuan deri në 6 mijë për një

kandidat, por rezultatet për partitë nuk u prekën. Anëtarët e KQZ-së i miratuan listat e kandidatëve të të gjitha partive përveç Listës Serbe, ku tre anëtarë votuan për, dy kundër (nga Lëvizja Vetëvendosje) dhe të tjerët abstenuan. Sipas KQZ-së, rezultatet përfundimtare janë: Lëvizja Vetëvendosje: 51.10% të votave, 57 ulëse; Partia Demokratike e Kosovës: 20.19%, 22 ulëse; Lidhja Demokratike e Kosovës: 13.24%, 15 ulëse; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: 5.50%, 6 ulëse. Nga ulëset e rezervuara për komunitetin serb, Lista Serbe fitoi nëntë ulëse dhe Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë një ulëse. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kritikuar shpalljen e rezultateve “të pjesshme” dhe veprimet e KQZ-së, duke thënë se situata nuk mund të zgjidhet me votim politik brenda institucionit dhe të vendimi për mosmiratimin e Listës Serbe është i pakuptimtë.

FSK-ja REALIZON KURSIN “COMBAT LIFE SAVER”



PRISHTINË, 2 SHKURT - Në Qendrën e Trajnimeve të Regjimentit të Mjekësisë të Komandës së Logjistikës është realizuar kursi “Combat Life Saver” që ka për qëllim përgatitjen e personelit ushtarak me njohuri dhe shkathtësi bazike dhe të avancuara mjekësore për të ofruar kujdes urgjent dhe efektiv në fushëbetejë, bazuar në standardet e NATO-s. Ky trajnim synon rritjen e mbijetesës së të plagosurve përmes menaxhimit të traumave, kontrollit të gjakderdhjes, ruajtjes së rrugëve të frymëmarrjes, stabilizimit të gjendjes së pacientit dhe përgatitjes për evakuim mjekësor, duke siguruar ndërhyrje të koordinuar dhe të standardizuar sipas protokolleve taktike të kujdesit para-spitalor.

Praktikë e re në UP: Doktorët e shkencës do të betohen në ceremoninë e diplomimit

PRISHTINË, 2 SHKURT - Për herë të parë në histori të Universitetit të Prishtinës, doktorët e rinj të shkencës do të betohen solemnisht në

ceremonitë e diplomimit. Universiteti i Prishtinës do t’u bashkohet institucioneve të arsimit të lartë në Evropë dhe shtete tjera të botës që

praktikojnë tekste zyrtare të betimit të të diplomuarve të doktoratës. Doktorët e shkencës së UP-së për herë të parë me

këtë tekst do të betohen në ceremoninë solemne që pritet të zhvillohet më 12 shkurt 2026.



AKB-ja: Shtrenjtimi i energjisë, goditje e rëndë ndaj ekonomisë së Kosovës

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka theksuar se paralajmërimi për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për 21.3% përbën një goditje të rëndë dhe të papranueshme për ekonominë e Kosovës, bizneset vendore, prodhimin dhe qytetarët, veçanërisht shtresat me të ardhura të ulëta. “Një vendim i tillë do t’i dëmtonte seriozisht

bizneset, do të largonte investorët potencialë dhe do ta shndërronte Kosovën në vendin më të shtrenjtë në rajon për të bërë biznes. Me çmime kaq të larta të energjisë, zhvillimi ekonomik, rritja e punësimit dhe qëndrueshmëria ekonomike bëhen të pamundura. Ky është një alarm kombëtar dhe kërkon reagim të menjëhershëm institucional. Nëse një vendim i

tillë miratohet, pasojat nuk do t’i bartin vetëm bizneset, por i gjithë vendi dhe çdo qytetar”, ka thënë ai. Shahini ka thënë se Aleanca Kosovare e Bizneseve kërkon që urgjentisht të krijohen institucionet e Kosovës, Kuvendi dhe Qeveria e re, dhe që kjo goditje e paralajmëruar e ZRRE-së ndaj ekonomisë së Kosovës dhe qytetarëve të saj të ndalet.



RAFUNA: RRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË DO TË GODASË BIZNESET DHE QYTETARËT, PAS RRITJES 16.1% TË VITIT TË KALUAR

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka deklaruar se OEK-u e sheh me shqetësim kërkesën për rritjen e çmimit të energjisë elektrike si për bizneset ashtu edhe për qytetarët, duke paralajmëruar se një rritje e re do të ndikojë drejtpërdrejt në koston e prodhimit, standardin jetësor dhe fuqinë blerëse.

Ai ka thënë për “Ekonomia Online” se për bizneset rritja e çmimit të energjisë rrit kostot operative dhe të prodhimit, sidomos për prodhuesit vendorë, duke theksuar se importet kanë kaluar mbi 7 miliardë euro, ndërsa eksportet kanë rënë në 940 milionë euro, krahasuar me 944 milionë euro një vit më parë. “E shohim me

shqetësim rritjen e çmimit të energjisë elektrike si për bizneset dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Për bizneset për shkak se e rrit koston e prodhimit, që çmimi i energjisë elektrike është kosto operative për bizneset dhe rrit koston e prodhimit, sidomos te prodhuesit ku e kemi pikën më të dobët për shkak se importet na kanë mbërri mbi 7 miliardë, kurse eksporti na ka rënë në 940 milionë euro, ndërsa vitin e kaluar e kishim 944 milionë euro. Ndërsa për qytetarët e Republikës së Kosovës e shohim për shkak të uljes së standardit jetësor dhe për shkak që një rritje tjetër do të ndikojë drejtpërdrejt në xhepat e tyre, po që do të ulet edhe si fuqi blerëse në kuptimin e konsumit



ose blerjes së mallrave dhe shërbimeve prej bizneseve. Kështu që, ne e shohim me shumë shqetësim rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe nuk mendojmë që është e drejtë një rritje e tillë mbas rritjes që e kishim vitin e kaluar

në prill prej 16.1% për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe nxjerrjen e bizneseve në tregun e lirë”, tha ai.

Ai ka shtuar se Oda Ekonomike do të presë zyrtarizmin e vendimeve për të bërë analizë të detajuar dhe për të kërkuar

përfshirjen e Qeverisë dhe të Zyrës së Rregullatorit për Energji Elektrike.

Rafuna ka paralajmëruar se një rritje e re e energjisë elektrike do të ishte goditje e rëndë për bizneset, duke përmendur se faturat për disa kompani që janë nxjerrë në tregun e lirë tashmë janë rritur nga 200 deri në 400 për qind.

KESCO ka kërkuar rritje mbi 21.3 për qind të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2026, duke u thirrur në rritjen e kostove operative dhe nevojën për sigurim të furnizimit të qëndrueshëm me energji.

Rritjen e çmimit të energjisë elektrike e kanë kundërshtuar qytetarët, partitë politike që nuk janë pjesë e pushtetit dhe shoqëria civile.

RRITET INDEKSI I PËRGJITHSHËM I ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BUJQËSORE



PRISHTINË, 2 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar indeksin e çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi për tremujorin e katërt (TM4) 2025.

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Në TM4 2025, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rënë

për (-0,8%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Kurse, indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 4,9%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 1,2%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë.

Në prodhimet blegtorale

çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve.

Po ashtu, në kuadër të prodhimeve blegtorale, çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë.

Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Rriten çmimet e pronave të banimit

PRISHTINË, 2 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Pronave të Banimit (IÇPB) për tremujorin e tretë (TM3) 2025, me vitin bazë 2018 =

100.

Indeksi i Çmimeve të Pronave të Banimit (IÇPB) në Kosovë u rrit me 2,4% në tremujorin e tretë (TM3) 2025, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2024. Ndërkaq, krahasuar me

tremujorin e dytë (TM2) 2025, çmimet e pronave të banimit pësuan rënie prej (- 2,1 %).

Në Rajonin e Prishtinës, çmimet e pronave të banimit u rritën për 1,3% në tremujorin e tretë (TM3) 2025,

krahasuar me tremujorin e tretë (TM3) 2024.

Për rajonet e tjera të vendit, çmimet e pronave të banimit u rritën për 4,3% në TM3 2025, krahasuar me TM3 2024.



FRIKA NGA AMERIKANËT, KUBA: NUK JEMI KËRCËNIM, JEMI TË HAPUR PËR DIALOG

Nën presionin amerikan që rritet dita ditës, qeveria kubane ka hedhur poshtë akuzat se përbën kërcënim për sigurinë e Shteteve të Bashkuara, duke theksuar se është e gatshme për dialog dhe bashkëpunim me Uashingtonin. Ministria e Jashtme e Kuba-s publikoi të hënën një deklaratë ku bën thirrje për dialog dhe nënvizon se vendi nuk mbështet “terrorizmin”. Reagimi vjen në një moment tensionesh të shtuara, pas rrëmbimit të liderit venezuelian Nicolas Maduro muajin e kaluar, ngjarje që u lidh me politikën e presidentit amerikan Donald Trump për dominimin e Hemisferës Perëndimore. “Populli kuban dhe populli amerikan përfitojnë nga angazhimi konstruktiv, bashkëpunimi ligjor dhe bashkëjetesa paqësore”, thuhet në deklaratën zyrtare nga Havana. “Kuba riafirmon gatishmërinë

për një dialog të respektueshëm dhe reciprok me qeverinë e Shteteve të Bashkuara, të bazuar në interes të ndërsjellë dhe në të drejtën ndërkombëtare.” Deklarata u publikua vetëm disa orë pasi Trump njoftoi se kontaktet diplomatike me Kubën janë rifilluar, duke thënë se administrata e tij po komunikon me “nivelet më të larta” të qeverisë kubane. “Kuba ka qenë një shtet i dështuar prej shumë kohësh. Tani nuk ka më Venezuelën për ta mbajtur në këmbë”, deklaroi Trump për gazetarët. Venezuela ishte furnizuesi kryesor i Kubës me energji, por pas rrëzimit të Maduros nga forcat amerikane, furnizimi me naftë është ndërprerë pothuajse plotësisht. SHBA-të kanë sekuestruar gjithashtu cisterna venezueliane me naftë në Karaibe, veprim që kritikët e kanë cilësuar si akt piraterie. Kuba kishte lidhje të ngushta



ekonomike dhe të sigurisë me qeverinë e Maduros, ndërsa afro 50 ushtarë kubanë humbën jetën gjatë operacionit të rrëmbimit të liderit venezuelian. Administrata Trump ka ushtruar presion edhe ndaj Meksikës për të ndaluar furnizimin e Kubës me naftë, duke ngritur shqetësime për një krizë të mundshme humanitare në ishull. Marrëdhëniet mes Uashingtonit

dhe Havanës janë armiqësore që prej revolucionit komunist të vitit 1959, që solli në pushtet Fidel Castro. Në vitin 2021, gjatë mandatit të tij të parë, Trump e futi Kubën në listën e “shteteve sponsorizuese të terrorizmit”. Së fundmi, Shtëpia e Bardhë publikoi një memorandum ku e cilëson qeverinë kubane si një “kërcënim të pazakontë dhe të jashtëzakonshëm” për SHBA-të,

duke e akuzuar për bashkëpunim me “aktorë keqdashës” si Kina dhe Rusia. Këto akuza u mohuan kategorikisht nga autoritetet kubane, të cilat theksuan se vendi nuk strehon baza të huaja ushtarake apo të inteligjencës dhe nuk mbështet organizata terroriste apo ekstremiste. Ndërkohë, Trump ka sugjeruar se një nga kërkesat kryesore të administratës së tij lidhet me trajtimin e komunitetit kubano-amerikan në SHBA, një elektorat i rëndësishëm për republikanët në Florida. Këtë linjë të ashpër ndaj Amerikës Latine e mbështet edhe Sekretari amerikan i Shtetit Marco Rubio. Tensionet janë ndjekur me shqetësim edhe nga Vatikani. Papa Leo deklaroi se është i alarmuar nga përshkallëzimi i situatës dhe u bëri thirrje palëve për dialog të sqartë, për të shmangur dhunën dhe vuajtjet e mëtejshme të popullit kuban.

A ËSHTË TRUMP MË POPULLOR NGA SA SUGJEROJNË SONDAZHET?

Sondazhi i fundit i Pew Research, i publikuar të enjten e shkuar, zbuloi se 37% - pak më shumë se një e treta e amerikanëve - miratojnë performancën e Trump-it. Përditësimi i fundit i Gallup në dhjetor e vendosi atë në 36%, me një vlerësim mosmiratimi prej 59%. Këto shifra nuk janë të mira për asnjë udhëheqës, në asnjë vend, por Trumpi, veprimet e të cilit gjatë vitit të tij të parë në detyrë, si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht, kanë qenë të diskutueshme, nuk është plotësisht jopopullor. Ajo që po e ul vlerësimin e tij të miratimit është imazhi i tij midis mbështetësve demokratë, të cilët nuk ka gjasa të kalojnë votën e tyre as për Trumpin as për Partinë Republikane. Trumpi gëzon mbështetje njëshifrore midis votuesve demokratë. Nga ana tjetër, mbështetja e tij te republikanët mbetet pozitive. Edhe pse ka rënë që nga fillimi i mandatit të tij, më shumë se gjysma duket se ende e mbështet qasjen e tij, sipas Pew.

Trumpi vazhdon të kryesojë një Amerikë hiperpartizane

Pavarësisht shifrave kombëtare, kontrolli i Trumpitmbi Partinë Republikane mbetet i rëndësishëm, kryesisht si figura emblematike e lëvizjes MAGA, e cila ungjillëzon mantrën e saj të gjatë "Amerika e Para". "Ne kemi një president që, historikisht, i mungon mbështetja," tha për DW John Mark Hansen, politolog në Universitetin e Çikagos.

"Mbështetja që ai ka duket se është e palëkundur: duket se nuk ka asgjë që ndoshta mund t'i kthejë mbrapsht 80-85% të votuesve republikanë." Trumpi ka qenë në gjendje të qeverisë vitin e tij të parë praktikisht pa asnjë opozitë falë kontrollit republikantë Kongresit të SHBA dhe një vendimi të Gjykatës Supreme të vitit 2024 që i jep imunitet të gjerë presidencës. Kjo mund të ndryshojë pas zgjedhjeve të mesit të mandatit të nëntorit, në të cilat të gjitha 435 vendet në Dhomën e Përfaqësuesve dhe një e treta e Senatit janë në garë. Ndërsa ai ka zbatuar tarifat gjithëpërfshirëse dhe politikat e ashpra të imigracionit që premtoi gjatë fushatës së tij, premtimi i tij për të frenuar inflacionin, për të përmirësuar koston e jetesës dhe për të nxitur ekonominë në përgjithësi mbeten për t'u parë. "Popullariteti i një presidenti nuk është kurrë më i lartë se në vitin e tij të parë," i tha DW-së Kathryn Dunn Tenpas, eksperte për presidencën dhe Kongresin në Qendrën Miller në Universitetin e Virxhinias. "Me kalimin e kohës, popullariteti i një presidenti ka tendencë të bjerë, pjesërisht sepse ai ka bërë premtime ekstravagante që nuk mund t'i përmbushë. Dhe në të njëjtën kohë, në rastin e presidentit Trump, mendoj se ajo që ka ndodhur është se amerikanët janë shumë të shqetësuar për situatën ekonomike dhe gjendjen e portofoleve të tyre," tha ajo. Mbështetja nga votuesit e moderuar që nuk identifikohen si republikanë ose demokratë, dhe që ndihmuan në ngritjen e

Trump-it në Shtëpinë e Bardhë, ka rënë gjithashtu. Sipas të dhënave të Gallup-it nga dhjetori, vetëm një në katër të pavarur e miratuan performancën e Trump-it. Ndërsa çështje të tilla si qasja agresive - tani vdekjeprurëse - ndaj bastisjeve të emigrantëve në zonat urbane mund të zemërojnë votuesit me prirje të majta, Tenpas tha se këto pika tradicionalisht të forta për Trump mund të armiqësojnë amerikanët e qendrës dhe të djathtën e moderuar. "Sigurisht, shumë demokratë janë veçanërisht të shqetësuar për atë që po ndodh në Minnesota dhe qytete të tjera në të gjithë vendin ku është vendosur ICE," tha Tenpas. "Përsa u përket të pavarurve dhe ndoshta republikanëve që nuk janë besnikë ndaj Trump-it, mendoj se ata po bëhen gjithnjë e më të pakënaqur me atë që po ndodh." Republikanët aktualisht kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve dhe Senatën, por një referendum për Trumpin do t'i shqetësonte aleatët e tyre në Kongres se një dyzinë garash thelbësore të papërcaktuara midis kandidatëve republikanë dhe demokratë mund të ktheheshin në favor të kundërshtarëve të tij dhe ta bënin të humbiste kontrollin e Dhomës.

Pak gjasa që ndërhyrjet në botën e jashtme të tërheqin vëmendjen e votuesve

Pas një viti në post, Trumpi ka

treguar se është ende në gjendje të irritojë homologët e tij ndërkombëtarë dhe ta lërë rendin botëror në një gjendje të pasigurt. Tarifat e tij kanë tronditur tregtinë globale, shkurtime të tij në ndihmën e huaj kanë përmbysur dekada të tëra progresi në zhvillimin ndërkombëtar, dhe sulmet e tij ndaj Iranit dhe veprimet e tij kundër ish-presidentit të Venezuelës kanë tensionuar më tej opinionin publik. Veprimet e Trumpit i kanë habitur ata që e shohin atë si figurën emblematike të një Amerike izolacioniste, dhe propozimi i tij për të aneksuar Groenlandën dhe Kanadanë si territor të SHBA-së ka zemëruar aleatët e tij të vendosur. Imazhet e bastisjeve të ICE të kryera nga administrata e tij kanë tërhequr gjithashtu vëmendjen globale. Por vëzhguesit thonë se këto çështje zbehen në krahasim me shqetësimet kryesore të brendshme që ka të ngjarë të zënë vend qendror para zgjedhjeve të mesit të mandatit. Trumpi rrallë është prekur nga perceptimet jopopullore jashtë Shteteve të Bashkuara. Brenda vendit, ai ka qenë më fleksibël, siç dëshmohet nga retorika e tij e fundit në lidhje me "shtensionimin" e bastisjeve të ICE-së.

SHBA: Trump do të "shtensionojë" pas të shtë-nave vdekjeprurëse në Minneapolis

"Pothuajse gjithmonë, ekonomia është çështja numër një," tha



Todd Belt, politolog në Universitetin George Washington, duke shtuar se ekziston një përjashtim. "Në masën që politika e jashtme do të ndikojë në zgjedhjet e mesmandatit, fakti që administrata aktuale po përqendrohet në çështje të tjera në vend të çështjeve të brendshme po dëmton imazhin e saj." Tenpas pajtohet, por tha se bastisjet ndaj emigrantëve brenda vendit gjithashtu mund të ndikojnë votuesit: "Mendoj se ngjarje të tilla si ato në Minnesota, Chicago, Los Angeles, dërgimi i trupave, ICE, janë më të paharrueshme në mendjet e votuesve." Ajo që duket e qartë është se, një vit pasi mori detyrën dhe pak më shumë se 10 muaj para zgjedhjeve të mesmandatit, Trump ka kohë të mjaftueshme për të ndryshuar narrativën. "Zgjedhjet janë ende larg, dhe opinionet e amerikanëve [...] rreth politikave janë të përkohshme", thotë Belt, "Ajo që është lajm një ditë mund të mos jetë lajm ditën tjetër" shton ai. "Dhe presidenti është një mjeshtër i shpërqendrimit, gjë që funksionon në favor të tij, sepse edhe pse po flasim për imigracionin tani, në tetor mund të flasim për diçka shumë të ndryshme", perfundoi ai./DW

INTERVISTË SPECIALE E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË BDI-së, ARBËR ADEMI

ADEMI: GJYKATA KUSHTETUESE DHE LIGJET DISKRIMINUESE PO KTHEJNË SHQIPTARËT PARA VITIT 2001

INTERVISTË E PLOTË
EKSKLUZIVE E SEKRETARIT TË
PËRGJITHSHËM TË BDI-SË
ARBËR ADEMI DHENË
GAZETËS LAJM ME
GAZETARIN FEJZI HAJDARI

G: Safe City nuk po zbret nga aktualiteti i fundit. Nga ana juaj si opozitë dhe nga VLENI si pjesë e Qeverisë kemi marrë vlerësime të ndryshme. Ndërsa ata e mbrojnë këtë masë, ju keni një qëndrim tjetër. Cili është qëndrimi i vërtetë dhe vlerësimi i partisë suaj?

ARBËR ADEMI: I gjithë opinioni e dinë që BDI nuk ka dhënë mbështetje në Kuvend me votë konkrete që të miratohet një ligj i tillë, kemi pasur dilema që në fillim, kemi ngritur çështje që është dashur të adresohen në këmbim të mbështetjes sonë. Çështja e parë ka qenë që një zbatim i tillë i masave për sigurinë në komunikacion të jetë i implementuar në tërë territorin e shtetit, jo vetëm në disa qytete. Jo vetëm në Kumanovë, Shkup dhe Tetovë. Çështja e dytë ka qenë vetë-implementimi i obligimit ligjor për dy-gjuhësi. Çështje e cila edhe sot, para se të vi këtu në emision te ju, mua më erdhi dënimi apo vërejtja për këtë moment, sepse dënimet fillojnë nga 1 shkurti, vetëm në gjuhën maqedonase. I kemi parë edhe tabelat e ndryshme, të cilat paralajmërojnë se gjithë rruga është në mbikëqyrje të kamerave, janë gjithashtu në gjuhën maqedonase. Poashtu çështja e tretë e cila është e natyrës teknike, e cila tangon çdo qytetar ka të bëjë me harmonizimin e sinjalistikës. Pra kemi një mos-harmonizim. Për shëmbull kemi paralajmërim që shpejtësia maksimale të jetë 70, ndërsa do duhej të jetë 50. Ju si qytetarë, nëse vozisni 60 do ju vjen dënimi. Pra, edhe kështu raste ka në praktikë. Çka e kanë konfirmu edhe ekspertë të ministrisë së punëve të brendshme, që duhet një harmonizim i sinjalistikave në tërë territorin e vendit. Prandaj, duke dashur që mos lihet përshtypja e një ligji diskriminues, i cili diskriminon vetëm qytetarët e 3 qyteteve, ndërsa e qytetarët e qyteteve tjera të mbarë territorit shtetëror të mos i nënshtrohen një mase të tillë ligjore. Ne nuk kemi dhënë mbështetjen tonë dhe sigurisht këtë e kemi thënë në mënyrë të hapur para mbarë opinionit. Parimisht, që në fillim kemi thënë po, mirëpo me këto



çështje të cilat do të duhet të adresohen. Ato nuk u adresuan nga pushteti aktual, dhe sigurisht mbështetjen tonë nuk e mori ligji.

G: A i keni bërë analizat e nevojshme se pse pikërisht ky sistem i sigurisë për qytetarët, pse po testohet në këtë periudhë vetëm në këto tre qytete, të cilat sapo i përmendet. Cili mund të jetë qëllimi, sepse për absurditete kemi fol edhe në emisione tjera.

ARBËR ADEMI: Është shumë e vërtetë, prandaj kemi thënë që duhet të ketë harmonizim të sinjalistikës. Sinjalistikë adekuate, është një prej çështjeve që e kemi ngrit që në fillim. Këto shqetësime janë ngritur nga qytetarë të ndryshëm. Duke filluar nga cenimi i privatësisë, për arsye se çdo gjë fotografohet, filmohet brenda në veturë. Dhe çdo gjë tjetër. Deri të diskriminimi. Prandaj, edhe këto çështje nga ana jonë janë ngritur. Çështje të tilla janë ngritur edhe nga vetë opinioni, nga qytetarët. Shohim që ka një revoltë të theksuar. Nëqoftëse jemi për sigurinë e qytetarëve, atëherë duhet të jemi për sigurinë e të gjithë qytetarëve, jo vetëm në tre qytete. Por në tërë territorin e vendit. Ndoshta do duhej të ishte

një pilotim i një mase të tillë në këto 3 qytete, derisa të bëhen gati edhe qytetet tjera, pastaj të implementohet njëkohësisht në tërë territorin e shtetit.

Mirëpo, për fat të keq pushteti aktual nuk i dëgjoj këto vërejtjet tona, dhe dilemat. Të cilat janë të karakterit substancial dhe që nuk cenojnë sigurinë e qytetarëve, komunikacionit, mirëpo shohisin argumentet të cilat me të drejtë nga opinioni ngriten. Pse në këto tre qytete? A po cenohet privatësia, a po diskriminohen qytetarët e një regjioni të caktuar. Po edhe cilat janë intencat e fshehta që mund MPB-ja, përmes një sistemi të tillë të sigurisë, eventualisht të keqpërdor edhe të dhënat e qytetarëve.

G: Edhe ASH-ja e Taravarit, njësoj si para disa ditëve e zotit Sela, e kanë ankimi ligjin me të cilin hyn në fuqi edhe Safe City. A pritet një gjë të tillë ta bëni edhe ju parti?

ARBËR ADEMI: Një nga anëtarët e këshillit të përgjithshëm të BDI-së, të njëjtën ditë kur zoti Sela ka dorëzuar proces për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së safe city, e ka bërë edhe ai, bëhet fjalë për Ylli Paçukun. Zoti Paçuku që nga e hena, e ka dorëzuar një iniciativë të

tillë. Dhe nuk është çështje e shumësisë së iniciativave, sa është çështje e përmbajtjeve, se cilat janë bazat që e atakojnë ligjin, i cili mundëson implementimin e saj.

G: Nëse merren në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, a jeni optimist se do të ndryshohet diçka në të mirën e qytetarëve.

ARBËR ADEMI: Duke e pasur parasysh se si po vendoj GJK, prej se është formu kjo qeveri monoetnike, pa legjitimitet etnik, nuk na bën që të jemi optimist. Nuk na bën duke filluar prej shfuqizimit të balancuesit, pa kurrëfarë argumenti profesional, pastaj disa tentativa për shfuqizim të ligjit për gjuhën shqipe, madje vetë jeni dëshmitar se në media edhe referati i cili ishte përgatitur për 11 dhjetorin e vitit 2024, 75 faqe referat. 18 dispozita përgatiteshin që t'i shfuqizojnë nga ligji për gjuhën shqipe. Nuk do të kishte ligj për gjuhën shqipe, s'do të kishte gjuhë shqipe zyrtare. Jemi dëshmitar që edhe pse kemi një ligj të tillë, detyrim ligjor për t'u respektu. Pushteti nuk e respekton. Edhe për safe city, edhe kumtesat të cilat ju vijnë nga ministra përkatës, që edhe publikisht nuk kanë hezituat të thonë i lëshojmë

vetëm maqedonisht, ata të cilët kanë interes t'i marrin në gjuhën shqipe, le të na drejtohen. Që e bëjnë edhe një pengesë shtesë, në drejtim të arritjes së informacionit thelbësor. Po pastaj shfuqizimi i legalizimit të medresës Isa Beu nga Gjykata Kushtetuese, pastaj zvogëlimi i numrit të këshilltarëve. Që ishte veprim kontradiktor, i vetë Gjykatës Kushtetuese me një vendim paraprak të saj, që e kishte marrë 1 muaj më herët. Ku GJK thotë nuk guxon që të ketë kategorizim rezident dhe jo-rezident, të gjithë janë shtetas të RMV-së, të gjithë gëzojnë të drejta që ua njeh rendi politik dhe juridik i vendit. Pas një muaji e gjysëm e fshinë diasporën. Madje, tani informacionit e fundit flasin edhe për hapjen e lëndëve të caktuara të cilat kanë të bëjnë me emërtimin e rrugëve nga viti 2005-2006-2007 që kjo Gjykatë Kushtetuese i ka hapur tani për të vlerësuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Në vend që të merren me çështje të rëndësishme, që me të vërtetë ka të bëjë me ndeshje të kushtetutës e ligjit, ata merren me çështje të tilla, me tendencën për të hapur tema të mbyllura, të kahmotshme.

Dhe ju e dini që kur bëhet fjalë për çështje të karakterit etnik, aty ndahen gjyqtarët në linja etnike, si në vitet 90-ta, para viteve 90-ta me mbivotim etnik. Gjyqtarët maqedonas në njërin anë, dy gjyqtarë shqiptar dhe një turk në anën tjetër. Dhe këta të komunitetit jo-maqedonas, po mbivotohen, po majorizohen. Atë mbivotim të cilin nuk mund ta realizojnë sot në organet e pushtetit shtetëror, nuk mund ta realizojnë në Kuvend, në këshillat komunal, as në qeveri se për çështje të caktuara aty vendimet merren me konsensus, por nëqoftëse thehet konsensusi lëshohet qeveria, ata po e realizojnë përmes GJK. Edhe paramendojeni, prandaj prej këtu buron kërkesa jonë, edhe nga Kongresi i 20 dhjetorit i BDI-së, që të gjitha aktet të cilat janë miratuar me shumicë të dyfishtë, të miratohen me shumicë të dyfishtë edhe në GJK, edhe ka një bazë logjike kjo. Nqs e merrni nenin 28, paragrafi 3, i ligjit për referendum. Çka parasheh? Ai parasheh që për ligjet të cilat i sjell kuvendi me shumicë të dyfishtë, fare nuk mund të shpallet referendum, fare nuk mund të vendosin qytetarët me referendum. Paramendojeni.

Qytetarët përmes referendumit mund të vendosin për ndryshim të kufijve, për bashkim apo ngjitje më ndonjë shtet tjetër, por nuk mund të vendosin për ligje të cilat janë sjellur me shumicë të Badenterit. Cila është logjika, është që të evitohet majorizimi. Sepse ai majorizim na solli 2001-shin. E tash qytetarët me referendum nuk mund të prononcohen për një çështje të tillë, por gjashtë gjyqtarët maqedonas PO. Ku është logjika që ato akte të cilat i sjellim me Badenter, të shfuqizohen pa Badenter. I gjithë ai investim, kapital politik, ato negociata, ai proces inkluziv të cilët e shoqërojnë një akt të caktuar ligjor, që sillet me Badenter, harxhohen energji, muaj, kohë, shpenzime që në fund gjashtë gjyqtarë, pa kurrëfarë argumenti profesional, se po të kishin argument profesional, do e kishim pranë, po pa kurrëfarë argumenti profesional vendosin për abrogimin e ndonjë akti ligjor që është sjellë me shumicë të dyfishtë. Prandaj kjo është kërkesa jonë, si BDI, që mos të ketë majorizim në GjK, të ketë shumicë të dyfishtë, jo për të gjitha çështjet, por për ato akte për të cilat është vendosur me shumicë të dyfishtë. Pra janë disa prej temave të cilat i ka hapur GjK. Dhe që na bën që të revoltohemi për arsye se nuk ka argumente profesionale. Gjykata Kushtetuese është shndërruar në një institucion parapolitik, që çon agjendën e VMRO-DPMNE-së përpara, të cilët votojnë vetëm me diktat politik. Pa kurrëfarë argumenti. Duke patur sfondin e juristi ligjerues në Universitetin e Tetovës, në fakultetin juridik, uroj që të jemi gjallë e sheëndos që ta shohim dhe do të jemi dëshmitar se atë çka ka vendos GjK, veçanërisht për rastin e Balancuesit, do të studiohet, do të analizohet, jo vetëm nga studentët në të ardhmen, po nga analet e drejtësisë botërore, se si një isntitucion kaq i rëndësishëm, siç është GjK, pa kurrëfarë argumenti profesional, por me diktat partiak, vendos për një çëshjte të tillë kaq sensitive. Është qersharake. Paramendojne, gjK thotë aty se është absolutuar nevoja e përdorimit të balancuesit për punësime dhe avansime. Ju lutem, GjK nuk është aty, nuk e ka për mandat vlerësimin se është absolutuar nevoja apo jo që të kemi përfaqësim të drejtë dhe adekuat, apo flet për keqpërdorimet e balancuesit. GjK nuk është aty për të dhënë vlerësime, se a keqpërdoret një normë e caktuar ligjore apo jo, mandati i tyre është i qartë, kristal i qartë, ato duhet të vlerësojnë vetëm kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Përkundër amendamentit të 6-të Kushtetutës, i cili thotë përfaqësim i drejtë dhe adekuat i të gjithë qytetarëve, i bashkësive etnike në të gjitha organet e pushtetit shtetëror.



Kështu thotë. Përkundër këtij amendamenti 6 që buron nga Marrëveshja Paqësore e Ohrit, sot i ikorporuar në Kushtetutën e vendit, këta thonë sot me fjalë të tjera është absolutu nevoja e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, është absolutu nevoja e balancuesit, po keqpërdoret, jashtë mandatit të tyre, nuk është çështje e tyre. Nëse dikush bën keqpërdorim ligjor përgjigjet. Mos të harrojmë se ky mekanizëm, nga 0.2% na solli në 23.8%. A ka pas keqpërdorime, ka pasur, jemi dëshmitarë, por ato përbëjnë përjashtime, se t'kishte qenë keqporimi i rregullt, atëherë ne nuk mund ta rrisnim nga 0.2 në 23% të arrijmë. Gjatë rrugës ka pasur keqpërdorime, kemi ngritur në qeveri këtë problem, madje ministri Lloga gjatë qeverisjes me ne propozoj rregullore aso kohë kur në certifikatën e lindjes duhet të ketë grafë për përkatësi etnike dhe ju e dini se kur konkuron për një vend pune, 6 muaj më të re duhet ta keni certifikatën e lindjes dhe të shtetësisë, dhe duhet të shënojë se përkatësie etnike ke. Nqs ju dëshironi ta ndrroni përkatësinë etnike, OK, lejohet, mundet, si religjionin, si emrin personal. Por duhet ta ndjekni njëfarë procedure institucionale, jo për kurrëfarë procedure zyrtare dhe institucionale. E njëjta GjK, jo për vërejtje përmbajtësore, por për vërejtje formal ministrit Lloga ia analoj rregullore sepse brenda tetë ditëve nuk është publikuar në gazetën zyrtare. A e dini se sot sa ligji, ligji jo aktet nënligjore, edhe sot e kësaj dite publikohen përtej afatit tetë ditor. A e dini se më herët njëri nga profesorët juridik këtu të Justiniani i parë në Shën Kirili dhe Metodi, ka humbur lëndë, ai ka kërkuar që të shfuqizohet një akt i caktuar, se brenda tetë ditëve nuk është publikuar në gazetë zyrtare, e ka humb lëndën. Pra për të njëjtën, GjK vendos në mënyrë diametralisht ndryshe. Mënyrë kundërthënëse. Ku po shkojmë ne, a do duhet të mendojmë të reflektojmë si qytetarë të këtij vendi, se çfarë institucionesh

kemi, çfarë njerëz na përfaëqsojnë, ku është kredibiliteti i tyre profesional, ku është kredibiliteti i tyre moral, që janë betuar se do të respektojnë kushtetutën dhe ligjin, kur e kanë marrë mandatin janë betuar, ndërsa atë betim e shkelin në çdo hap. Vetëm e vetëm për të na kthy neve shqiptarëve para vitit 2001. Për të na mbivotu. Për të na majorizu. Për na e tregu vendin apo siç thonë disa ata analistët e tyre, tash është koha e pjesës së dytë të lojës në mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Ata e thonë, jo ne. Prandaj ne po themi, ngadalë, se nuk e dini se çfarë dëmi jeni duke i bërë këtij shteti, nuk e dini se çfarë dëmi jeni duke i bërë vendit. Këtu do të duhet një reflektim i thellë edhe mos të lejohen devijime të tilla. Për të mos lejuar do duhet çelësi i shumicës së dyfishtë për aktet e sjellura me shumicë të dyfishtë edhe në GjK. Po e rikthesoj edhe një fjalë të fundit sa i përket GjK, se opinionin nuk është i njoftuar, s'besoj se edhe ju jeni të njoftuar me të gjitha temat është duke i hapur GjK, i ka në proces. Këtu shihet një tendencë e qartë, shihet një tendencë e qartë për të deformuar Marrëveshjen e Ohrit, për ta deformat gjithë sistemin politik të vendit. Po duke tentuar që të na bëjnë neve dëm, janë duke i bërë dëm edhe vetvetes. Pse? Se të ligji për balancuesin, paramendoni, ekziston obligim ligjor i çdo insitucioni që të mos i identifikojë në bazë të etnisë qytetarët të cilët i ka të punësuar, pra asnjë institucion nuk ka të drejtë më të na identifikojë në bazë të përkatësisë etnike, dhe pas këtyre vendimeve skandaloze, a e dini cilin dëm e kanë bërë, duke tentuar neve të na bëjnë dëm, sot nuk ka asnjë institucion, asnjë dokument zyrtar që do të provoj se X personi është maqedonas, apo Y personi është shqiptar. Pra shqiptarëve ua kanë mohu, por edhe vetvetes ia kanë mohu një të drejtë të tillë. S'ka asnjë dokument, s'ka asnjë institucion që lëshon një dokument të tillë. Që një X

person është i kësaj apo asaj përkatësie etnike.

G: Kryeministri Hristijan Mickoski ditë më parë paralajmëroj, se ligji për përfaqësim të drejtë dhe adekuat është gati, ndërkohë që nuk la pa përmendur edhe pjesën tjetër që ishte më kontradiktore, se gjatë punësimit patjetër duhet merret parasysh kriteri i cilësisë. Ju në profilin tuaj ne facebook, keni shkruar, po e citoj: I ashtuquajturi ligj i Karakamishevës për përfaqësim të drejtë dhe adekuat, i hartuar nga VMRO dhe i mbështetur me entuziazëm të pashpjegueshëm nga VLEN, është akt i pastër i regresit politik, a është vërtetë që aq i dëmshëm është ky ligji në krahasim me mekanizmin të cilin ju kohë më parë e kishi aplikuar gjatë procesit të punësimit?

ARBËR ADEMI: Çështja është shumë e thjeshtë. Derisa funksiononte balancuesi kishte kuota etnike. 10 vende pune hapeshin, 3 shqiptarë, 5 maqedonas, 1 turk a ishte kështu? Se ato shpallen edhe në gazetën tuaj, konkurset. Prej se u shfuqizua balancuesi, a ka më vende e kuota etnike për bashkësitë etnike, nuk ka. Merrni gazetën tuaj, hapeni, prej shfuqizimit të balancuesit. Kur të miratohet ky ligj, të më mbani për fjale, po e ritheskoj të mbani për fjalë, prap nuk do të ketë kuota etnike, s'ka më kuota etnike.

G: Prandaj e theksova këtë për cilësinë, se aty fshihet djalli.

ARBËR ADEMI: Po cilësia ka ekzistuar edhe te balancuesi, mirëpo kuotat etnike kanë qenë aty. Në bazë të cilësisë, ne emër të cilësisë, deri në vitin 2001 ne 0.2 përqind, a q ne shqiptarët kemi qenë të paafte që të mos jemi në organet shtetërore, që të jemi 0.2, a q kemi qenë të paafte. Sot po e shohim, prej Marrëveshjes së Ohrit, prej këtij balancuesit që na u kanë hap dyert me hy në çdo institucion, në spitale, në insitucione arsimore, shkencore, shëndetsore, të administratës shtetërore. Dhe ne sot, jo vetëm ne, se ne e kemi ditur që kemi

njerëz të aftë, por edhe maqedonasit sot i apostrofojnë shqiptarë të cilët janë të zotët. Që nuk dëshiron një mjek tjetër t'i operoj, por mjeku shqiptar. Po mos të kishte qenë ky balancuesi, si do të hynin këto shqiptarë, po të mos kishin qenë këto kuotat etnike, si do të futeshin shqiptarët. Prandaj po them, kur e shfuqizuan balancuesin, shfuqizuan kuotat etnike. Kur të miratohet ky ligji i Karakamishevës, asgjë nga sot që po e them nuk do të ndryshojë, të më mbani për fjale, nuk do të ketë kuota etnike. Cilësia, cilësia si para 2001-shit, 0.2 që na ka mbajt neve edhe mbajnë llogari për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat. Si me mbajt llogari për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat kur nuk ka kuota etnike, kur nuk ka mekanizëm që e përcjell përfaqësimin e drejtë dhe adekuat, si te balancuesi që tregon sa vende për shqiptarë e maqedonas. Pastaj, si do të ketë përfaqësim të drejtë dhe adekuat, si lajm, edhe që se njihni ndoshta sferën e drejtësisë, kur ekziston obligim për institucionet për mos t'i identifikuar qytetarët në bazë të përkatësisë etnike. S'guxon asnjë institucion me më pyët mua as juve se çfarë përkatësie etnike kemi, si do të kemi përfaqësim të drejtë dhe adekuat? Si do të kemi përfaqësim të drejtë dhe adekuat kur nuk ka asnjë dispozitë sanksionuese. Nuk mund të ketë sanksion kur këto tre të parat nuk ekzistojnë. Është një fjalë në letër, letra duron gjithçka, por gjendja reale nuk do të ndryshojë asgjë. Të më mbani për fjale, nuk po flas këtu sot vetëm si sekretar i përgjithshëm i BDI-së, po flas edhe si profesor i drejtësisë i cili edukon e formon profesionalisht breza të tërë në UT, nga viti 2009 e këndeje, pra janë bërë më tepër se 17 që jam në fakultetin juridik, jo rastësisht dhe një nga antarët e grupit punues të këtij ligji, shqiptar, një profesor doli publikisht kundër këtij ligji. Karakamisheva e ka shkruar. A pritni ndonjë ligj të mirë nga zonja Karakamisheva. Sigurisht që jo. Qytetarët e dijnë. Unë do doja që zonja Karakamisheva të kishte reflektuar, por jo. Ligjin, draftin që e kam analizuar unë me një ekip të tërë brenda BDI-së. Na dërgon në këto konkluzione. Që ta thjeshtësojmë, si me këtë ligj, si pa këtë ligj situata nuk ndryshon fare. S'ka kuota etnike, s'ka përfaqësim të drejtë dhe adekuat, edhe kështu do të jemi, siç jemi sot, siç kemi qenë para vitit 2001. Tjetër kur shënon në ato konkurset, 6 vende të rezervuara për shqiptarë, për turq, për rom, për boshnjakë, për maqedonas. Këtu më nuk ka.

G: Realisht gjatë periudhës tuaj kur keni qenë në pushtet ka pasur raste kur në emër të kuotave të cilat janë caktu për shqiptarët, janë punësuar maqedonas duke u deklaruar si shqiptarë.

ARBËR ADEMI: Edhe anasjelltas

ka pas. Unë e thash. A ka pasur situata të caktuara, të izoluar të keqpërdorimit. Ka pasur. Mirëpo nqs nuk do të funksiononte ky mekanizëm nuk do kishim arrit nga 0.2 në 23%. Ky mekanizëm na solli 23%. Po shihni sot, shihni konkurset të cilët edhe ne si BDI deri para pak kohe i ndjekshim dhe i publikonim rezultatet në bazë të emrave të njerëzve, se sa janë shqiptarë e sa maqedonas. 60 me zero, 52 me zero, 50 me dy e kështu me radhe.

Nqs qytetarët mendonjë ndryshe, unë e respektoj qëndrimin e tyre. Nqs administratorët dhe njerëzit të cilët punojnë në institucione, mendojnë se unë nuk po e them të vërtetën dhe kanë një mendim tjetër, unë do t'ju përulëm të gjithë atyre dhe e pranoj mendimin e tyre. Mirëpo neve na kontaktojnë shumë njerëz brenda ditës, të cilët na japin informacione të sakta në çdo institucion se çfarë po ndodh me vlerën kushtetuese të quajtur përfaqësim i drejtë dhe adekuat. Në mënyrë brutale na ka kthyer para periudhës së vitit 2001. Para vitit 2001 na kanë kthy. Këtë nuk e them për politikë, nuk jemi në fushatë, kjo çka na është bërë neve me këtë vendim të GjK për balancuesin, edhe unë kam thënë atëherë, është në të njëjtin rang me tentativën që na bëjnë me gjuhën shqipe. Mos jetë edhe më e rëndësishme kjo e para. Ti nuk të drejtë të deklarohesh, deklarimi yt që je shqiptar. Kërkush s'ta mohon këtu para kamerës suaj të bërtasim që jam shqiptar. Por ajo irrelevante është për në institucion. Pse je shqiptar, pse je i ndonjë i komuniteti tjetër, është irrelevante në bazë të këtij vendimi të GjK.

G: Zotri Ademi, a do të përfshihen bullgarët në Kushtetutë, a do të ketë ndryshime kushtetuese, sepse gjykuar edhe pas deklaratës së sotme të kreut të ekzekutivit Mickoski, jep një përshtypje se më pak është i interesuar për ta nxit, për ta shtyer këtë punë përpara, sa i përket ndryshimeve kushtetuese, që është problematikë e madhe, gur i madh në atë rrugëtimin e shtetit drejt Evropës. Bëj edhe një citat, i kryeministrit Mickoski, nga foltorja e Kuvendit deklaroj se: Nuk do të ketë ndryshime kushtetuese nëse nuk plotësohen dy kushte: Maqedonasit në Bullgari të marrin të drejtat e tyre të garantuara në përputhje me të drejtat ndërkombëtare dhe konventat për të drejtat e njeriut, si dhe të ketë garanci që Maqedonia nuk do të përballet me bllokada dhe obstrukcione të reja për arsye subjektive.

ARBËR ADEMI: Për fat të keq, çdo gjë që kemi deklaruar para zgjedhjeve të vitit 2024, çdo ditë po vërtetohet. Fatkeqësisht. Këtu unë shoh edhe rolin e partive politike shqiptare të cilat nqs mund t'i quajmë shqiptare, të cilat janë në qeveri tani. Ato bashkë me ne, përpara

zgjedhjeve të 2024 kanë nënshkruar deklaratë që kanë marrë përsipër të gjitha partitë politike që nuk do të ketë qeveri me një parti politike e cila nuk i bën ndryshimet kushtetuese, e cila nuk ka një orientim të qartë evropian. Të gjithë janë zotuar! Pastaj, përfaqësuesit e VLEN-it thanë nuk do të ketë qeveri pa ndryshime kushtetuese gjatë fushatës. “Mos e keni merak” e relativizonin, ka kush kujdeset. Nuk do të ketë qeveri pa ndryshimet kushtetuese e kështu me radhë. Pastaj thanë brenda 3 muajve do të inicohet procesi, sa të kryhen zgjedhjet në Bullgari, do të inicohet procesi. Pastaj thanë brenda 6 muajve, edhe u kry kjo punë. 2 vite u bënë. Asnjë N prej ndryshimeve kushtetuese nuk kemi. U futën në qeveri me një mashtrim të madh se do të bëhen këto ndryshime kushtetuese dhe këto nuk janë vetëm në të mirën e shqiptarëve, por integrimi evropian është në të mirën e të gjithë qytetarëve. Tash mundëmi me fol edhe prej përvojës sime personale. Unë kam qenë në grupin punues për hartimin e ndryshimeve kushtetuese. Ato

stadium i relacioneve tona me Bullgarinë për t'i bindur ata për të pranuar një gjë të tillë. Dhe fatkeqësisht, kryeministri është konsistent se atë e ka thënë edhe para zgjedhjeve, por këta të VLEN-it e mbulonin me fjalë të bukura, se nuk do të ketë ndryshime kushtetuese. Ne po e shohim që për dy vite s'ka ndryshime kushtetuese. Unë parashtroj një pyetje hipotetike. A do të kishte qeveri pa shqiptarët. Fare. Nqs të gjithë shqiptarët do të ishin distancu nga ky kurs i rrezikshëm i shtetit. Nga ky orientim i rrezikshëm i shtetit. Që përbën devijim nga përcaktimi strategjik i shtetit që është anëtarësimi në BE. Me siguri se po të kishte rezistencë, në këtë drejtim, nga faktori politik shqiptar. Mos të ishin këta që janë sot në qeveri, të kapur nga VMRO-DPMNE-ja, nuk do ta kishim një situatë të tillë. Nqs do të qëndronin stoik me ato qëndrime para zgjedhjeve të 2024, se s'ka qeveri pa ndryshimet kushtetuese, ne deri sot do i kishim kry këto ndryshime kushtetuese. Por fatkeqësisht ka në qeveri njerëz të cilët në bazë të preferencave,

sekretar, kush janë ata njerëz. Pse po e them këtë, jo për të qenë ironik. Larg asaj. Por dua vetëm kemi këndellje dhe të shkojmë një hap mbrapa dhe të kendjellemi, kush po na përfaqëson, a na përfaqësojnë parti apo individë që mbajnë llogari për vetën, me një klan që janë në gjendje të shesin çdo gjë shqiptare, vetëm për një ditë më tepër të jenë në kolltuqet e Qeverisë. Kjo është dilema. Se për mua, ata le të vazhdojnë, jo këto dy vjet, edhe dy tjera, edhe derisa e gjejnë një trend të tillë, le të vazhdojnë edhe më tepër. Por vetë turpërohen, edhe dëmi që i bëhet shtetit, edhe shqiptarëve në këtë rast është i madh. Janë njerëz pa parti. E kam quajtur edhe në raste tjera. Janë një lloj Frankenshtajni politik i zotri Mickoski, i cili do copa i ka bashku, ti quhesh LD, ti Alternativë, ti Besa, ti Lëvizja Arbëria. Hajde të ju bashkojmë, pa organe, pa asgjë, ju jeni përfaqësuesit e shqiptarëve. Nuk e don kështu përfaqësuesi i shqiptarëve. Përfaqësuesi i shqiptarëve duhet të burojë prej poshtë, prej qytetarëve. Nuk është problem pse jemi në

po vendime merren në ato mbledhje, krijohen politika. Andaj, kjo jo vetëm që se ka legjitimitetin etnik, por edhe aspektin legal e ka diskutabil, nëse e shikojmë nga prizmi i amendamentit 6. Dhe këta të tjerët, që mos të mërzhiten, le të rrijnë derisa janë të dobishëm për zotëri Mickoskin kanë me ndejt aty, besoj ashtu, pa kurrëfarë legjitimiteti, pa kurrëfarë partie. Është një lloj Frankenshtajni politik që e ka kriju zotri Mickoski, për nevojat e politikës së tij. Dhe po i hec mirë. Dëme të mëdha sa të duash – shtetit, dëme të mëdha sa të duash – marrëdhënieve ndëretnike, kohezionit të brendshëm shoqëror sa të duash. Ta shohim, të arrijë një pikë që do të konstatojmë që kjo ka qenë një politikë shumë shumë e gabuar.

G: Pas takimit të kreut të ekzekutivit me liderët, doli lajmi se do të ketë një takim në mes Mickoskit dhe zotrit Ali Ahmeti. Kjo bile me sa e di unë u konfirmua edhe nga partia juaj. Do të ndodh një takim i tillë, dhe çfarë eventualisht do të bisedohet në atë takim?

ARBËR ADEMI: Një gjë e tillë u konfirmua pas takimit të liderëve edhe nga kryetari Ali Ahmeti edhe nga kryeministri Mickoski. U konfirmua se kryetari Ali Ahmeti e tha një gjë të tillë publikisht para gazetarëve, edhe kryeministri Mickoski e tha po të njëjtën publikisht, para gazetarëve. Vetëm për ta sqaru para opinionit: Kur kryetari Ali Ahmeti ka marrë ftesën nga organizatori i takimit, nga zotëri Mickoski, kryeministri, për të organizuar mbledhjen, sigurisht se kemi pasur komunikim të drejtpërdrejtë në mes BDI-së dhe VMRO-së për ta organizuar takimin ashtu siç duhet. Për arsye se takimet e tilla kërkojnë përgatitje, kërkojnë definim të agjendës, definim të rendit të ditës, e mos të jetë takim sa për disa pamje televizive e disa fotografi për opinion. Dhe ata janë njoftuar nga ne, lidhur me temat të cilat janë të rëndësishë etike.

G: Cilat janë ato?

ARBËR ADEMI: Rëndësisë substanciale. Temat të cilat i flasim ne në vazhdimësi. Integrimi evropian, pika e parë. Ku janë ndryshimet kushtetuese. Afat. Ne kemi thënë se ne jemi parti serioze dhe konsistente, kemi thënë edhe pse jemi në opozitë padrejtësisht, ne i mbështesim blanko ndryshimet kushtetuese. Ne nuk jemi sikur këta që thonë: Jo, nqs na pranohet një ameandament për mos-vjetërsimin e veprave penale, që shpikin tema. Ju kujtohet 2022-2023, këta përfaqësuesit e VLEN-it, vetëm mos t'i votojnë ndryshimet kushtetuese i bën ato, ndërsa sot a i përmendin, janë në qeveri, le t'i ngrisin. Ridefinimi, ju kujtohet mirë. Eja le ta ngrisin atë temë, a



ndryshime të cilat i proceduan në Kuvend, në 2023, pjesë e hartimit të atyre ndryshimeve, formalisht kam qenë edhe unë si përfaqësues i BDI-së. Asgjë të keqe nuk ka. Madje unë shoh benefit të bashkëqytetarët tanë maqedonas nqs i procedojnë dhe miratojnë këto ndryshime kushtetuese. Nqs më herët politika e institucioneve bullgare thoshin se bëhet fjalë për të njëjtin komb, të njëjtin popull, por që jeton në dy shtete, në Bullgari dhe Maqedoni, edhe ishin ata asokohe që nuk pranonin që të njihet minoriteti bullgar këtu, me këtë arsyetim s'ka komunitet, pse komunitet bullgar, këta që janë maqedonas thonin se janë si ne. Tani është momenti, dje ishte momenti, para 2023, 2022 ishte momenti ku me këto ndryshime kushtetuese njëherë e përgjithmonë të behej distinkcion mes popullit bullgar dhe maqedonas. Ku çelikoset identiteti i bashkëqytetarëve tanë maqedonas. Dhe është dashur shumë punë që të vijë deri te kjo situatë, deri te ky

jo në bazë të asaj që i ka votuar dikush, nuk kanë fituar zgjedhje, janë në qeveri dhe bëjnë amin të çfarëdo lloji qëndrimi të kryeministrit, për arsye se ata nuk përfaqësojnë asgjë. Ata nuk janë një zë që përfaqëson dikend. Ata përfaqësojnë vetëm veten dhe inetersat e ngushta personale dhe klanore brenda partive të tyre, nëse mund t'i quajmë parti se as parti s'janë. Shembull e marrim Lëvizjen Demokratike, a mundeni ju me m'tregu se kush është nënkryetar te LD-ja? Kush është sekretar i përgjithshëm i LD-së? S'kanë organe. A ju kujtohet zotri Mexhiti derisa ishte në BDI thoshte duhet sa më shpejtë të formohen organet, të punojnë organet, po në në LD katër vite gati që është formu, asnjë organ nuk e di. One man shoë është aty. Kush po na mban ligjerata e leksione morale. Po te Alternativa, kush është nënkryetar? Po të Lëvizja Besa kush është nënkryetar? Kush është sekretar gjeneral të LB? Po te këta Lëvizjet tjera me 3-4 persona, kush është nënkryetar,

opozitë. Unë uroj që BDI të jetë në pozitë si fituese, çdoherë. Mos të vjen puna ta humbim besimin e popullit, këtë nuk e dua për BDI-në. Po pse është BDI në opozitë s'është problem. Në mënyrë të padrejtë, jo ligjore. Amendamentin 6 nëse e analizojmë, dmth: Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i të gjitha bashkësive etnike, në organet e pushtetit shtetëror. Edhe Paul Ëilliams që e angazhuam ne për një analizë për legjitimitetin edhe për vet Marrëveshjen e Ohrit, a e dini se çfarë gjetje ka? Thotë: Ky amendament, pra i 6-ti, te parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat nuk është vetëm një parim që do duhet të respektohet gjatë procesit të punësimit dhe avansimit, por edhe në procesin e vendimmarrjes, në organet e vendimmarrjes, sepse fjalët e fundit të këtij amendamenti janë: përfaqësim i drejtë dhe adekuat në organet e pushtetit shtetëror. E këto organe i numëron kushtetuta se cilat janë, është e qeveria. Proces vendimmarrës a kemi në qeveri,

guxojnë? Edhe ne, integrimin evropian kërkuam deadline. Qeveria me Badenter, GjK me Badenter, Marrëveshja kombëtare për përparim e zhvillim të qëndrueshëm, që zotëri Ahmeti e përmendi në Kongresin e vet. Kjo Marrëveshja kombëtare për përparim është se nqs ne si shtet kemi treguar kapacitete se mund ta arrijmë Marrëveshjen e Ohrit, të Prespës, për Fqinjësi të mirë me Bullgarinë, eja ta arrijmë një Marrëveshje kombëtare për përparim, për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, për digjitalizim, për inovacione, për politika të qëndrueshme e të gjelbra e kështu me radhe. Të cilat zotëri Ahmeti i ka paraqitur në Kongres. Jo vetëm tema etnike të cilat këta po i hapin, këta po na i hapin, po na rikthejnë prapa, jo ne. Nga ne ka vetëm reaksion ndaj këtyre çështjeve këta po i devijojnë. Edhe për të gjitha këto çështje kanë qenë të njoftuar organizatorët. Takim mendoj se duhet të ketë, edhe do të ketë me një moment të përshtatshëm. Për arsye se takimet e tilla për temat të cilat janë të natyrës jetike dhe substanciale, nuk janë çështje të preferencave momentale individuale. Edhe tekanjoziteteve individuale. Po të kishte mbetur që takimet e tilla të jenë për këto çështje, atëherë ne nuk do kishim parë kurrëfarë takimesh as në të kaluarën në mes të liderëve. Ata nuk ulen aty sepse kanë preferenca e dashni për njëri tjetrin. Por për shkak të domosdoshmërisë së trajtimit të temave me rëndësi jetike për vendin, organizohen takime të liderëve. Edhe shmangia nga temat e tilla shkon si kontraproduktive për shtetin. Se ne themi Qeveri me Badenter, GjK me Badenter. Këto dy çështje ndikojnë edhe në forcimin e karakterit unitar të shtetit për arsye se nqs se shqiptarët i majorizoni, atëherë shqiptarët do të ndihen si të huaj në këtë vend. Dhe do të paraqiten edhe forca tjera politike që do të ofrojnë alternativa tjera për organizimin e shtetit. Jo kështu siç jemi. Jo me karakter unitar siç jemi. Po me siguri se do të ketë alternativa të tjera. Që jo rrallë janë liferuar në opinion. Prandaj ne si parti politike e përgjegjshme themi, hajde ta forcojmë karakterin unitar të shtetit. Duke respektuar Marrëveshjen e Ohrit, duke respektuar amendamentin e 6-të, duke pasur Badenter në formim të qeverisë, duke pasur Badenter në GjK. Ma thoni, pse BDI-ja duhet të jetë parti serioze politike, pse duhet të jetë parti e reformuar, pse duhet të ketë program të mirë, pse duhet zgjidhjet më të mira kadrovike se opONENTI, se edhe po t'i fitojë zgjedhjet, dikush tjetër thotë shumë mirë, ke fitu por spostohu atje. Se nuk je i preferuar i imi. Edhe çfarë situatë krijohet? Këtu do të krijohen situata ku elitat politike shqiptare më shumë do të ishin të interesuara për

kohabitacion me fituesin potencial te maqedonasit, ta kenë mirë me atë fituesin që po vjen, që të jenë pjesë e qeverisë, sesa për kërkesat reale të qytetarëve. Dhe kështu dalëngadalë vjen deri te shkëputja e lidhjes politikan – parti – qytetar. Mirëpo qytetari nuk mbetet i paorganizuar. Populli do të prodhojë një rrymë tjetër, një alternative tjetër politike e cila mund të del edhe me kërkesa radikale. Si rezultat i deligjitimitimit të këtyre elitave që janë të interesuara vetëm për kohabitacion me fituesin potencial maqedonas. Prandaj ne themi, si serioz në këto tema. A e doni karakterin unitar të shtetit, ne jemi, por karakteri unitar i shtetit forcohet duke i adresu këto çështje, duke mos e deformu Marrëveshjen e Ohrit. A jemi për bashkëjetesë, ne jemi. A jemi për një demokraci funksionale multietnike, Po, atëherë këto çështje. Aleksis Podvill, Zhan Zhak Ruso e filozof të tjerë që i kanë trajtu temat e demokracisë koncisiative. Ata thonë në një shoqëri ku kemi ndarje, në qoftë në karakterin ideologjik, etnik, politik, demografik, religjioz e kështu me radhë, demokracia nuk duhet të kuptohet si qeverisje e shumicës, për arsye se shumica mekanike, “I kam 61 vota e bëj çka të dua”, ajo nuk prodhon efekt por thellon polarizimin e hendequn në shoqëri. Prandaj duhet të ketë mekanizma mbrojtës, për komunitetet jo-shumicë. Kjo që e propagandon sot, e angazhohet BDI-ja, Zhan Zhak Ruso e Aleksis Stokvill e filozof të tjerë i ka të shkruara, i kanë të studiara, mirë të menduara se si do të funksionoj një shoqëri e cila ka ndarje. Si në rastin tonë. Prej më tepër etnive përbëhet, e tash ani majorizimi teknik, ajo shumica teknike, neve ku na sjellin. A ju kujtohet në vitet 90-ta, PPD e PDSH, ku ishim e ku erdhëm. Çfarëdo që propozonin deputetët shqiptarë, ata thonin mirë është por nuk keni vota. Na mbivotonin. Ku na solli ajo mendësi e majorizimit. Ai mentalitet i mbivotimit, ku na solli. Na solli te 2001-shi. Në 2001 e dham dorën, OK, karakter unitar të shtetit Po, por duke i integruar shqiptarët dhe komunitetet e tjera. Duke paraparë mekanizma mbrojtës ndaj majorizimit në procesin e vendimmarrjes. E tash, për gati dy vite ne kemi një deformim të Marrëveshjes së Ohrit. Andaj këto janë tema të cilat janë të rëndësisë jetike, e VLEN-i nuk e ka kapacitetin as politik, as ndikimin shoqëror, po besa as dijen e as përvojën për t'i trajtuar me seriozitet këto tema.

G: Zotëri Ademi. Çështja e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme ka qenë shumë intenzive, shumë më të zëshëm keni qenë para zgjedhjeve lokale. Mes dy raundeve zgjedhore, sikur nivelin e zërit për zgjedhje të parakohshme parlamentare e



ulët. Tani së fundmi ku kanë ngel këto punë, do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare?
ARBËR ADEMI: Jo nqs i keni përcjell qëndrimet e BDI-së me vëmendje, ne jemi konsekuent në këtë drejtim, një ditë e më përpara duhet të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Duhet të respektohet amendamenti 6. Duhet të kemi qeveri me Badenter. Këto janë çështje të cilat me prioritet duhet t'i shqyrtojmë dhe vlerësojmë, dhe të shkojmë në zgjedhje. Të shkojmë në zgjedhje, edhe nqs nuk frikësohen nga humbja, ejani, kanë një arsye më të tepër që të shkojmë në zgjedhje. Le ta pranojnë sfidën. Shumë më mirë është që le të fitojnë dhe si fitues le të jenë këta oponentët tanë në qeveri. Ka edhe një epërsi psikologjike kur ulesh si fitues në tryezën e vendimmarrjes. Mund ta ngritësh zërin se e din se si rezultat i fitores je aty, jo si rezultat i preferencave të mandatarit, të kryeministrit. Se kështu siç janë, këta nuk mund ta ngrejnë zërin për asgjë. Për arsye se kryeministri Mickoski, ju thotë: Shikoni se sa për vota ju s'ishi këtu, por si rezultat i asaj që unë ju kam kriju, dhe unë ju preferoj të jeni këtu. Prandaj, ta qepeni gojën. Mos të hapni çështje që mua më shkaktojnë probleme. Dhe këta bëjnë amin. Prandaj unë po them, BDI nqs nuk i fiton zgjedhjet, nuk e ka vendin në qeveri. Unë do të jem kundërshtar i parë i ndonjë ideje, por e di se ashtu fryme nuk ekziston brenda BDI-së. I humb zgjedhjet, e ke vendin në opozitë me reflektu. I fiton zgjedhjet, populli të ka dhënë përgjegjësi. Përgjegjësia nënkupton edhe një votë më tepër. Kemi pa ne llojlloj raste në të drejtën e krahasuar, kur njerëzit fitojnë edhe me dy vota, 3 vota e 5 vota, por fitojnë besimin. Demokracia nënkupton edhe këtë. Edhe një votë më tepër, e lë më me mbi 30 mijë, e 20 e ca mijë tani në zgjedhje lokale. Le të fitojnë një votë më tepër, le t'u qëndrojnë konsekuentë atyre fjalëvë në fushatën e 2024, kur thonin nqs


del BDI del një votë më tepër, ne japim dorëheqje e pensionohemi politikisht, madje edhe në noter thonin t'i verifikojmë këto deklarata publike. Por nuk e mbajtën fjalën. Ashtu si nuk e kanë mbajtur për asgjë. A premtuan President të zgjedhur nga Parlamenti. Ku është kjo? Në programin e VLEN-in është. A thanë do riformulojmë 20%shin, që të jetë gjuhë shqipe? Ku është ajo procedurë? A thanë se ministri të diasporës do formojnë, ku është? Diasporën e kanë fshi, edhe nga dotacionet, edhe nga asistenca shtetërore edhe nga gjithçka tjetër. Numrin e këshilltarëve e zvogëluan, duke përjashtuar diasporën. A thanë ministrinë e brendshme do ta kemi, ku e kanë? A thanë drejtorin për siguri publike do ta kemi, ku e keni? A thanë do themelojmë bankë shqiptare, ku është banka shqiptare? A thanë se çdo qytetar nga 10 mijë euro do ja japin si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, a i keni marrë 10 mijë euro nga qeveria? JO. As unë jo, asnjë qytetar jo. Akademia shqiptare e institucionalizume, ku është? Dashtën pak para zgjedhjeve lokale, me një kështu Frankenshtajn zgjidhje, po e financon kjo apo ajo komunë. Edhe ashtu ishin kundër. As ashtu s'po e mbajnë. E shumë e shumë premtime tjera të cilat i kanë dhënë. Ma thoni, një çështje për të cilën e kanë mbajtur fjalën. Një që e kanë në program? Vetëm një fjali që e kanë mbajtë fjalën, që e kanë në program. Asnjë fjalë nuk e kanë mbajtur. Jo si politikan, jo si përfaqësues i BDI-së, nuk dua të më përfaqësoj dikush që nuk e mban fjalën. Nuk e ka kredon morale, që gënjen ditën, pastaj gënjen pasditë, në darkë para gjumit edhe një gënjeshtër më të mirë për gjumë të ëmbël. Nuk na duhen kështu lloj politikanësh.

G: Për në fund, për një çështje për të cilën dua të ju pyes është

reagimi juaj në lidhje me dënimin penal të gazetares Liridona Vejseli, se ju reaguat, e pash në profilin tuaj në facebook.
ARBËR ADEMI: Gjithmonë jam në krah të gazetarëve, edhe kur nuk pajtohem.

G: Neve nuk na keni kursyer shumë si media kur ishit në pushtet.
ARBËR ADEMI: Unë dhe BDI, po këtë e flasin edhe indeksimet ndërkombëtare, liria e medias e patë se ka rënë për nuk e di sa vende tani, më duke për 12 vende ka rënë në Maqedoni. Edhe kjo flet për gjendjen se si kemi qenë dhe si jemi. Por personalisht, gjithmonë jam në anën e gazetarëve. Edhe kur nuk pajtohem, edhe kur nuk pajtohem totalisht. Zonja Liridona Vejseli, është një gazetare goxha aktive, dhe të penalizohet si rezultat i asaj që e ka kry detyrën e vet, për t'i informuar qytetarët, në interes publik, mendoj se kjo flet shumë për mentalitetin i cili mbisundon në institucione të caktuara, nga individë të caktuar të cilët duhet ta marrin përgjigjen ligjore, adekuate. Prandaj, jo vetëm për Liridona Vejselin, por prej se jam në politikë, për më tepër gazetarë të cilët nuk janë trajtuar siç duhet, qoftë nga qytetarët, qoftë nga institucionet, kam dhënë mbështetjen time dhe çdo kohë do e jap mbështetjen. Tjetër çështje është se a më pëlqen politika redaktuese e zotëri Hajdarit, pra është tjetër çështje, mund të polemizojmë, të debatojmë. A më pëlqen politika redaktuese e zonjës Vejseli, krejt është çështje tjetër. Po, ndonjëherë mediat, gazetarët duke qenë edhe kritik, e nxjerrin më të mirën e mundshme nga ti.

G: Kur nuk janë tendencioz
ARBËR ADEMI: Prandaj unë i vlerësoj. Edhe në BDI gjithmonë mund të gjejë partner në këtë drejtim.
G: Zotëri Ademi, falemnderit për kohën dhe këto minuta që i keni ndarë për këtë emision.



Anderlecht shkarkon Besnik Hasin

ANDERLECHT, 2 SHKURT - Skuadra belge Anderlecht ka vendosur të ndërpresë bashkëpunimin me trajnerin shqiptar Besnik Hasi pas rezultateve negative në Superligën e Belgjikës. Në tre

ndeshjet e fundit, Anderlecht ka regjistruar dy humbje dhe një barazim, çka ndikoi në vendimin e klubit. "RSC Anderlecht po e mbyllë marrëveshjen me kryetrajnerin Besnik Hasi dhe e

falënderon për punën dhe përkushtimin e treguar", ka njoftuar Anderlecht. Edward Still do të marrë drejtimin e ekipit të parë përkohësisht, deri në emërimin e trajnerit të ri

kryesor. Hasi njihet si trajneri më i suksesshëm i Kosovës dhe është konsideruar disa herë për pozicionin e përzgjedhësit të kombëtares shqiptare, pa ndonjë vendim konkret.



PËRMBYLLET GRUMBULLIMI TREDITOR I KOMBËTARES U17, STAFI TEKNIK I KËNAQUR ME PUNËN E BËRË

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kombëtarja e Kosovës U17 në konkurrencën e vazhduar e ka përmbyllur sot grumbullimin seleksionues treditor në Kampin Nacional në Hajvali, me një ndeshje testuese, që u zhvillua në kuadër të përgatitjeve për kualifikimet për Euro 2026, që do të mbahen në fund të shkurtit dhe fillim të marsit në Portugalë. Gjatë këtyre tri ditëve, stafi teknik pati mundësinë të vlerësojë nga afër potencialin e lojtareve, formën e tyre fizike

dhe aspektet tekniko-taktike, me qëllim ndërtimin e një grupi sa më të kompletuar dhe konkurrues për sfidat e vështira që e presin këtë gjeneratë në Ligën A. "Ne si staf jemi të kënaqura me atë çfarë treguan vajzat. Ky grumbullim na shërbeu në procesin e seleksionimit dhe përgatitjes së ekipit, duke krijuar bazë të mirë për vazhdimësinë e punës", ka thënë përzgjedhësi i kësaj grupmoshe, Sanije Krasniqi. Më tutje, ajo ka bërë me dije se në këtë grumbullim nuk janë

përfshirë lojtaret që janë pjesë e ekipit e që luajnë jashtë vendit, pasi potenciali i tyre tashmë është i njohur për stafin teknik, pasi ato kanë qenë pjesë e Kombëtares edhe në kualifikimet e mëhershme. Rikujtojmë se Kosova U17 do të përballet me kundërshtarë të fortë në kualifikimet e Ligës A, si Portugalia, Spanja dhe Hungaria, por përkushtimi dhe puna e treguar gjatë këtij kampi është sinjal se kjo gjeneratë mund të vazhdojë me rezultate tjera pozitive.



JUVENTUSI TENTOI TA FUS ZHEGROVËN NË BISEDIME ME EVERTONIN PËR SULMUESIN BETON

TORINO, 2 SHKURT - Everton ka refuzuar një qasje të Juventusit për sulmuesin Beto gjatë javës së kaluar, ndërsa bisedimet mes dy klubeve që përfshinin Edon Zhegrovën nuk kanë shënuar asnjë përparim. Gjiganti italian po kërkon të përforcojë repartin ofensiv gjatë afatit kalimtar të janarit. Beto, ish-sulmuesi i Udineses dhe aktualisht pjesë e

Evertonit, ishte vetëm emri i fundit në listën e lojtarëve të shqyrtuar nga "Zonja e Vjetër", pas Jean-Philippe Mateta dhe Youssef En-Nesyri, shkruan "The Athletic". Megjithatë, sipas raportimit, Evertoni refuzoi edhe të hapte diskutime për një huazim të mundshëm të sulmuesit portugez drejt Torinos. Sipas "The Athletic", arsyeja kryesore



e refuzimit lidhet me shqetësimin e Evertonit për të gjetur një zëvendësues të

përshtatshëm për Beton në këtë fazë të sezonit. Klubi anglez nuk dëshiron të dobësojë repartin ofensiv pa pasur një alternativë të sigurt. Në raport shtohet se gjatë kontakteve mes dy klubeve është diskutuar edhe mundësia e një transferimi të Edon Zhegrovës drejt Evertonit. Megjithatë, negociatat nuk

kanë avancuar dhe palët nuk kanë arritur në fazë konkrete. Ndërkohë, Juventus ka arritur marrëveshje për transferimin e anësorit Jeremie Boga nga OGC Nice dhe mbrojtësit të djathtë Emil Holm nga Bologna. Sipas gazetarit italian Alfredo Pedulla, objektivi më i ri për repartin ofensiv është ish-kapiteni i Interit, Mauro Icardi.

DANIMARKA SHPALLET KAMPIONE E EVROPËS NË HENDBOLL

HERNING, 2 SHKURT - Ekipi danez i hendbollit është kampioni evropian i hendbollit. Në finalen e luajtur në Herning të Danimarkës, ata mposhtën Gjermaninë me rezultatin 34:27 dhe u bënë kampione evropiane për herë të tretë. Shënuesit më të mirë për fituesit e turneut ishin Simon Pytlick me tetë dhe Johan Hansen dhe Mathias Gidsel me shtatë gola secili, ndërsa më efikasët për



Gjermaninë ishin Johannes Golla, Juri Knorr dhe Marko Grgić me pesë gola secili. Që nga fillimi, Danimarka dukej si një ekip që ishte një hap përpara Gjermanisë, por ata kurrë nuk arritën të shkëputeshin me një avantazh të konsiderueshëm. Në fillim, portieri gjerman, Andreas Wolff, gjithashtu u dallua, duke bërë disa pritje të rëndësishme. Danezët, nga ana

tjetër, nuk mund të mbështeteshin shumë te Emil Nielsen, i cili nuk mbrojti në nivelin e tij të zakonshëm, kështu që Kevin Moller hyri dhe bëri disa pritje të rëndësishme. Danezët arritën të shkëputeshin me një avantazh më të madh vetëm pas rreth 10 minutash lojë, Gjermania ngadalë u lëkund dhe nuk ishte në gjendje të mbante ritmin. Fitorja dukej e sigurt, por disa gabime i lejuan

Gjermanisë të mbetej dy gola prapa 10 minuta para fundit. Megjithatë, gjermanët nuk arritën ta zvogëlonin epërsinë dhe të barazonin rezultatin, ndërsa Danimarka e rriti epërsinë, fitoi bindshëm dhe fitoi kampionatin. Kjo është hera e tretë në histori që danezët fitojnë Kampionatin Evropian, hera e parë që nga viti 2012 në Serbi. Ata ishin gjithashtu fitues në vitin 2008 në Norvegji.

Mitaj mund të bëhet shok skuadre me Ronaldon


RIAD, 2 SHKURT - Edhe pse mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Mario Mitaj ka kontratë me Al-Ittihad deri në verën e vitit 2028-të, por kampionët e Arabisë Saudite

kërkojnë opsion tjetër në linjën e majtë të mbrojtjes. Në të tillë situatë, alternativa e vetme për shqiptarin është gjetja e një klubi të ri, ndërsa orët e merkatos po shkojnë drejt fundit.

Gazetari sportiv në Arabi, Abdullah Al-Amri, i ka befasuar të gjithë në lidhje me raportimet për Mario Mitajn. Sipas tij, klubi i Al-Nassr i ka kërkuar Al-Ittihad huazimin e 22-

vjeçarit deri në fund të sezonit. Përgjigja e Al-Ittihad nuk ka vonuar, refuzim të menjëhershëm, pasi nuk dëshirojnë të forcojnë një rival të drejtpërdrejtë.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 11.03.2024, nenit 18 dhe nenit 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 226/26 të datës 30.01.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A, me datë 30.01.2026, shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

I. Titulli: Zyrtar pwr Prokurim Publik

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: Orar jo i plotw, por jo mw shumw se tridhjetw e nwnw (39) orw nw javw

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar tre (3) vjet, me mundwsi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Pwrgatitje Universitare

Kusht i veçantw: Tw jetw i certifikuar nw prokurim publik

Përvoja e punës: Njw vit

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Koeficienti i pagës: Caktohet me vendim tw veçantw tw Kryeshefit Ekzekutiv

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës kryesor për udhëheqjen e procedurave të prokurimit konform LPP të prokurimit në fuqi.
- Bashkëpunon me zyrat tjera në kuadër të ndërmarrjes, ofron këshilla dhe sugjerime në lëmin e prokurimit.
- Koordinon dhe menaxhon projektet e prokurimit dhe siguron që të gjitha procedurat dhe aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në pajtim me ligjin që rregullon procedurat e prokurimit në Kosovë.
- Ka autoritet të nënshkruajë kontrata dhe çdo dokument zyrtar për zyrën e prokurimit, në emër të autoritetit kontraktues dhe në përputhshmëri me LPP.
- Koordinon punën dhe siguron se të gjitha kërkesat për prokurim për mallra, shërbime, punë apo shërbime konsulente janë në rregull dhe të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe se janë në harmoni me procedurat e prokurimit.
- Është përgjegjës për caktimin e metodave të prokurimit, për procedurat e tenderit dhe kuotimin e çmimeve.
- Me Kryeshefin Ekzekutiv e koordinon çështjet e prokurimit dhe është personi kontaktues në mes KRRP (Komisionit Rregullativ të Prokurimit), AQP (Agjencionit Qendror të Prokurimit) dhe OSHP (Organit Shqyrtues të Prokurimit) lidhur me të gjitha procedurat e prokurimit.
- Harton raporte javore, mujore, tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e prokurimit që zhvillohen nga zyra e prokurimit.
- Merr pjesë në takime dhe siguron rrjedhën e informatave të duhura brenda ndërmarrjes.
- Për punët që kryen i përgjigjet Kryeshefit ekzekutiv.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Dwshmia e certifikimit nw prokurim publik (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara);

➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Intervista me gojë deri në shtatëdhjetë (70) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në tridhjetë (30) pikë.

➤ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 02.02.2026 deri me datë 16.02.2026 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 23.02.2026.
- Afati për ankesë nga data 24.02.2026 deri me datë 26.02.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 05.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 10.03.2026 deri me datë 12.03.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 18.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 19.03.2026 deri me datë 23.03.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 26.03.2026

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e Komisionit Vlerësues, dhe Departamentit të Personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

➤ Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 11.03.2024. godine, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donijetog od strane Upravnog odbora N.P.L. "Përparimi" Sh. A a na osnovu rješenja br. protokola 219/26 od 30.01.2026.godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L. "Përparimi" Sh. A od 30.01.2026, saopštava:

EKSTERNI JAVNI KONKURS

- I. Naslov: Lužbenik za javne nabavke
Broj izvršilaca: 1
Radno vrijeme: Nepuno radno vreme, ali ne više od trideset devet (39) sati nedeljno
Trajanje termina: Na određeno vreme od tri (3) godine, uz mogućnost produženja.
Stručna priprema: Univerzitetska priprema
Poseban uslov: Da bude sertifikovan za javne nabavke
Radno iskustvo: Jedna godina
Izveštava: Izvršnom direktoru
Koeficijent plate: Određuje se posebnom odlukom Izvršnog direktora

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Glavni je odgovoran za vođenje procedura nabavki u skladu sa važećim Zakonom o javnim nabavkama (ZJN).
- Sarađuje sa drugim kancelarijama u okviru preduzeća, pruža savete i sugestije u oblasti nabavki.
- Koordiniše i upravlja projektima nabavki i osigurava da se sve procedure i aktivnosti nabavke odvijaju u skladu sa zakonom koji reguliše procedure nabavki na Kosovu.
- Ima ovlašćenje da potpisuje ugovore i svaki zvanični dokument za kancelariju za nabavke, u ime ugovornog autoriteta i u skladu sa ZJN.
- Koordiniše rad i osigurava da su svi zahtevi za nabavku robe, usluga, radova ili konsultantskih usluga u redu, potpisani od strane odgovornih lica i u harmoniji sa procedurama nabavke.
- Odgovoran je za određivanje metoda nabavke, za tenderske procedure i kvotiranje cena.
- Sa Izvršnim direktorom koordiniše pitanja nabavke i kontakt osoba je između KRRP (Regulatorne komisije za javne nabavke), AQP (Centralne agencije za nabavke) i OSHP (Tela za razmatranje nabavki) u vezi sa svim procedurama nabavke.
- Sastavlja nedeljne, mesečne, tromesečne i godišnje izveštaje o svim aktivnostima nabavke koje sprovodi kancelarija za nabavke.
- Učestvuje na sastancima i obezbeđuje protok odgovarajućih informacija unutar preduzeća.
- Za rad koji obavlja odgovara Izvršnom direktoru.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Obrazac za prijavu L.P.P. „Përparimi“ A.D. - Vučitrn (skeniran);
- Kopiju lične karte (skenirana);
- Dokaze o školskoj kvalifikaciji (skenirani);
- Dokaz o sertifikaciji za javne nabavke (skeniran);
- Izvod iz matične knjige rođenih (sertifikat izvađen online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Uverenje o krivičnom kažnjavanju izdato od strane Sudskog saveta Kosova, da nema krivičnih kazni u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (sertifikati izvađeni online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeni);
- Dokaze o radnom iskustvu (skenirani);

- Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti
- Budite državljanin Republike Kosovo.
 - Imaju puni kapacitet za djelovanje.
 - Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

- Način vrednovanja kandidata.
- Usmeni intervju do sedamdeset (70) poena.
 - Biografija (CV) kandidata do trideset (30) poena.

- Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:
- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
 - Lekarsko uverenje.

- Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.
- Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 02.02.2026 do 16.02.2026 u 16:00 sati.

- Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:
- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 23.02.2026.
 - Rok za žalbu je od 24.02.2026 do 26.02.2026.
 - Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 05.03.2026.
 - Rok za žalbu je od 10.03.2026 do 12.03.2026.
 - Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 18.03.2026.
 - Rok za žalbu je od 19.03.2026 do 23.03.2026.
 - Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do 26.03.2026.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

- Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima
- Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu NPL "Përparimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

- Objašnjenje
- Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reči i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

➤ ZAKLJUČAK

NPL "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë: 03.02.2026

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) nën 24 dhe 35, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024) nën 21 dhe 33, nën 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit, Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2026 shpall:

KONKURS

- (1) Bashkëpunëtor shkencor për fund shek. XX. – zgjedhje.
- (1) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën osmane, zgjedhje/rizgjedhje.

Kandidatët/ja për Bashkëpunëtor shkencor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave.
- Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencorë për fushën (periudhën historike) që dëshmohet.
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim të publikuar në revista shkencore relevante ndërkombëtare.
- Të ketë pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, së paku në dy (2) konferenca kombëtare dhe në një (1) konferencë ndërkombëtare.
- Aftësi për kërkime shkencore.

Kandidatët/ja për Bashkëpunëtor të lartë shkencor duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave.
- Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën (periudhën historike) që dëshmohet.
- Të ketë një (1) vepër shkencore monografike pas zgjedhjes së fundit dhe një (1) vëllim me dokumente pas zgjedhjes së fundit nga periudha përkatëse, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe akademitë e shkencave.
- Të ketë më së paku 3 punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.
- Të ketë pjesëmarrje aktive së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.
- Përvojë së paku në një (1) projekt kërkimorë-shkencore, të realizuara nga institucionet kërkimore-shkencore dhe profesionale.
- Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse.
- Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara sipas akteve në fuqi.
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj.
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit shkencor dhe hulumtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nën 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, "Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve" dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore, si dhe në faqen e internetit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen dhe protokollohen në administratën e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, në adresën Eqrem Qabej nr. 111.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datum: 03.02.2026

Na osnovu Zakona Br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj delatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, Br. 11/02 Maja 2013), Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini (01B-195, od 31.10.2024. godine), člana 8 zakona Br. 03/L-212 o Radu, i Uredbe o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju i drugim relevantnim aktima Instituta, Naučno veće Instituta za istoriju "Ali Hadri" – Priština na sastanku održanom 27.11.2024. godine objavljuje:

KONKURS

- (1) Saradnik naučni za kraj XX veka – izbor.
- (1) Viši naučni saradnik za osmanski period, izbor/reizbor.

Kandidati za naučnog saradnika moraju ispuniti sledeće uslove:

- Da ima zvanje doktora nauka.
- Da pokaže visok nivo stručne kompetentnosti i naučnog iskustva u oblasti (istorijskom periodu) koji se dokazuje.
- Da ima objavljen najmanje jedan (1) rad u relevantnim međunarodnim naučnim časopisima.
- Da ima aktivno učešće na nacionalnim i međunarodnim konferencijama, najmanje na dve (2) nacionalne i jednoj (1) međunarodnoj konferenciji.
- Sposobnost za naučnoistraživački rad.

Kandidata za poziciju Viši naučni saradnik mora ispuniti sledeće uslove:

- Da ima zvanje doktora nauka.
- Da pokaže visok nivo kompetentnosti i naučnog iskustva u oblasti (istorijskom periodu) koji se dokazuje.
- Da ima jedno (1) monografsko naučno delo nakon poslednjeg izbora i jedan (1) tom sa dokumentima nakon poslednjeg izbora iz odgovarajućeg perioda, objavljene od strane naučnoistraživačkih institucija, visokoškolskih ustanova i akademija nauka.
- Da ima najmanje tri (3) naučna rada objavljena u relevantnim međunarodnim naučnim časopisima iz odgovarajućeg perioda, od kojih su dva (2) objavljena nakon poslednjeg izbora, kao i da je uspešno učestvovala/u organizovanju naučnoistraživačke delatnosti.
- Da ima aktivno učešće na najmanje dve (2) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna.
- Iskustvo na najmanje jednom (1) naučnoistraživačkom projektu, realizovanom od strane naučnoistraživačkih i stručnih institucija.
- Sposobnost za rukovođenje naučnoistraživačkim i akademskim projektima.

Potrebna dokumentacija

Kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Diploma o završnim relevantnim studijama;
- Diplome stečene u inostranstvu moraju biti overene u skladu sa zakonima na snazi;
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci;
- Biografija uz koga se moraju priložiti potrebni dokazi za dokazivanje situacije koja je u njoj prikazana;
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.).

Izbor naučnoistraživačkog osoblja Instituta za istoriju "Ali Hadri" vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 za istraživačko-naučnu delatnost (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/02 Maja 2013), Statuta Instituta za istoriju "Ali Hadri" – Priština (01B-195, od 31.10.2024.), člana 8. Zakona o radu br. 03/L212, "Pravilnikom o postupku izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača" i drugi relevantni akti Instituta.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina, kao i na sajtu Istorijskog instituta "Ali Hadri".

Uz prijavu se prilažu kopije dokumentacije o stručnoj spremi, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koja su potrebna za radno mesto za koje konkurišu.

Popunjeni zahtevi se podnose i evidentiraju u upravi Instituta za istoriju "Ali Hadri" u Prištini, na adresi Ekrem Cabej br. 111.



F2.3/BNJ/KP/PT



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokolli 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokolli 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitat pa test me nr. protokolli 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 30/01/2026 me numër të protokollit 02/01/60 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës: “Punëtor i Bartjes”
Nr. i kërkuar: Pesëmbëdhjetë (15) pozita, NJO Prishtinë në KRM “Pastrimi” SH.A
Numri i Referencës: KPJ/PT/NJOP/01/2026
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Periodha Provuere: 3 muaj

1. Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
- 1.2 Bënë zbrazjen e kontejnerëve në automjet/kamion;
- 1.3 Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
- 1.4 Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bënë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
- 1.5 Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripës;
- 1.6 Bënë largimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre në kontejnerin përkatës;
- 1.7 Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
- 1.8 Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët të vendosë në vendin paraprak;
- 1.9 Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
- 1.10 Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
- 1.11 Për punën e tij i raporton Kryepunëtorit të Bartjes në Njësi Operative.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detvërë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme)	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës	✓
Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

- * duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh. A.
- * në recepcionin e kompanisë.

5.2 Dorëzimi i aplikacionit:

- * Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
- * Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

6. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 03/02/2026 deri me datën 18/02/2026;
Koha e fundit e pranimi të aplikimeve është ora 16:00;
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

7. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronit dhe individualisht.

9. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Vecono” SH.P.K. pronar Feride Cuci me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812207729 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Vecono” D.O.O. Feride Cuci Gnjlane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812207729 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Vecono” L.L.C. with owner Feride Cuci with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812207729 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Tre vite pa nënën time të dashur

SHKURTE (EMIN) BISLIMI

(1954 – 2023)

Sot u bënë tre vite pa më të shtrenjtën, nënën time. Ditët, muajt dhe vitet po ikin, por malli për ty nuk shuhet kurrë.

Ndihem shumë krenare që pata një nënë me vlera të larta njerëzore.

Do të jesh gjithmonë në mendjen dhe zemrën time.

E përkujton me mall dhe krenari,

vajza Liridonë Bislmi Musa



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Floidea D.P.T. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin unik të biznesit: 811608069 të lëshuar nga ATL.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

Shqiprim Doda shpall të pavlefshme
dëftesën e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e
gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavarësisht dhe të pavarësisht e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Jeton Shala nga Rogova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu "Haxhi Hoti" nga kl. 1-8 , Rogov Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Taulant Rexha shpall të pavlefshme diplomën e sh.m..p. "Gjon Nikoll Kazazi".

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Krstjan Prenkaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Arigon Smajli shpall të pavlefshme diplomën e Gjymnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Osman Gjuga nga Lipoveci shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu "Shaban Gola" Lipovec Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Mati Logoreci" Prizren.

"FAR" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

